# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5783
E mërkurë, 22 maj 2019
çmimi 0.40 €


## Jahjaga thotë se korrupsioni po e ngulfat Kosovën

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI FAQE 4-5

# Të jemi të bashkuar në raport me krimet serbe në Kosovë



Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, e ka ftuar spektrin politik të jetë i bashkuar në raport me gjenocidin serb në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ka shumë arsye që faktori politik shqiptar për këtë çështje duhet të jetë i bashkuar. Sipas tij, askujt nuk i takon të deklarohet se mund apo nuk mund të themelohet tribunali ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Krasniqi ka thënë se institucionet e Kosovës duhet të punojnë në këtë drejtim. "Iniciativa mund të jetë një vrap për merita apo ndonjë arsye tjetër. Në këtë rast nuk duhet të merrem me gjëra të tilla. Një gjë dihet, krimet e gjenocidit serb nuk janë dënuar, por duhet të dënohen. Kjo është ajo që duhet të merremi vesh jo vetëm ne në Kosovë, por edhe drejtësia ndërkombëtare", është shprehur Krasniqi

## AKTUALE

UNITETI F.6



Hysni GUCATI

## EKONOMI

MBPZHR-ja HAP PERIUDHËN PËR APLIKIM PËR GRANTET INVESTIVE NË BUJQËSI F. 6



APOSTOLOVA: VETËM 10 PËR QIND E BIZNESEVE JANË NË PRONËSI TË GRAVE F. 9



KOSOVA KA ARRITUR PROGRES TË KËNAQSHËM NË MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE F. 9

# Kuvendi kërkon drejtësi për masakrën e Dubravës



Me rastin e shënimit të 20-vjetorit të masakrës në Burgun e Dubravës, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë mbajtur një seancë të veçantë në të cilën kanë kërkuar dënimin e kryerësve të këtij krimi. Ata kanë thënë se masakra e Dubravës është një nga krimet më të dokumentuara meqë ka shumë fakte, dëshmi dhe dëshmitarë të gjallë. Deputetët, njëherësh të mbijetuarit e kësaj masakre, përveç bashkësisë ndërkombëtare, kanë kritikuar edhe institucionet vendore që nuk kanë bërë asgjë për zbardhjen e kësaj masakre dhe për ndëshkimin e kriminelëve FAQE 3




## Bëhet thirrje që Kosova dhe Shqipëria të bashkëpunojnë më fuqishëm në aspektin ekonomik

FAQE 9

## SPORT

KASTRIOTI SYNON T'I JAPË FUND DOMINIMIT TË BESËS EDHE NË KAMPIONAT F. 18




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## FRONTEX vendoset në kufirin Shqipëri - Greqi




TIRANË, 21 MAJ - Një ekip i Agjencisë Evropiane të Kufijve (Frontex) do t'i bashkohet policëve të Shqipërisë në patrullime tokësore dhe detare për të ndihmuar në luftimin e krimit. Bashkëpunimi përfshin edhe çështjet e sigurisë sa iu përket emigrantëve.
Ky është bashkëpunimi i parë i këtij lloji që Bashkimi Evropian e ndërmerr në territorin e një vendi që nuk është anëtar i bllokut, thanë në Tiranë, komisionari për Migrim i Bashkimit Evropian, Dimitris Avramopoulos dhe shefi i Frontex-it, Fabrice Leggeri.
Komisionari Avramopulos tha se marrëveshja është "një moment historik në bashkëpunimin e BE-së me rajonin".
Ndërkaq, shefi i Frontex-it, Fabrice Leggeri, bëri të ditur se nuk ka asnjë afat kohor për këtë bashkëpunim të forcave të sigurisë shqiptare dhe atyre të BE-së. Pesëdhjetë oficerë, 16 makina patrullimi dhe një furgon që vijnë nga 12 vende anëtare të BE-së, do të vendosen përgjatë kufirit Shqipëri - Greqi.
Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Sander Lleshaj, tha se kishte një rritje prej gjashtë herë në numrin e kalimeve të paligjshme të emigrantëve nga kufiri grek në Shqipëri krahasuar me një vit më parë. Shqipëria nuk është një rrugë e preferuar për emigrantët, por disa hyjnë në Shqipëri për të lëvizur më pas drejt Evropës Veriore.

# Thaçi e Rama koordinohen për Samitin e Parisit

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar në Tiranë me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, me të cilin ka biseduar për ngjarjet politike në Kosovë, Shqipëri dhe rajon, si dhe për përgatitjet e Kosovës për Samitin e Parisit



PRISHTINË, 21 MAJ - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka qëndruar në Tiranë, ku është takuar edhe me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, me të cilin ka thënë se ka biseduar për aktualitetet politike në dy shtetet shqiptare.
Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se me Ramën ka biseduar edhe për përgatitjet e Kosovës për Samitin e Parisit, i cili pritet të mbahet më 1 korrik. "Si gjithmonë, kënaqësi takimi me kryeministrin Edi Rama. Biseduam për ngjarjet politike në Kosovë, Shqipëri dhe rajon, si dhe për përgatitjet e Kosovës për Samitin e Parisit", ka shkruar Thaçi.

### Meta thotë se Kosova e ka merituar heqjen e vizave

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur në takim zëvendëskryeministrin e Kosovës, Fatmir Limaj, me të cilin ka biseduar për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në mes të dy qeverive si dhe për proceset eurointegruese të dy shteteve shqiptare.
Meta ka thënë se forcimi i mëtejshëm i partneritetit të Kosovës me ShBA-në dhe BE-në garanton integrimin euroatlantik të saj. "Takim i përzemërt me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Fatmir Limaj, i cili më njoftoi me marrëveshjen e arritur të hënën ndërmjet dy qeverive për zbatimin e një sërë marrëveshjesh që do ta forcojnë më tej bashkëpunimin midis vendeve tona. Vlerësuam mbarëvajtjen e zgjedhjeve të pjesshme vendore të zhvilluara së fundmi në Kosovë. Kosova e ka merituar prej kohësh heqjen e regjimit të vizave me Bashkimin Evropian, duke i përmbushur tërësisht të gjitha kriteret. Forcimi i mëtejshëm i partneritetit të Kosovës me ShBA-në dhe BE-në, garanton integrimin euroatlantik të saj dhe konsolidon sigurinë në rajonin tonë", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".

## Basha fton qytetarët në protestën e 25 majit 'Shqipëria si Evropa'




TIRANË, 21 MAJ - Opozita do ta organizojë të shtunën protestën kombëtare kundër qeverisë "Rama". Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka postuar në rrjetet sociale posterin e këtij tubimi, që pritet të jetë më i madhi i organizuar nga opozita. Me thirrjen "Shqipëria si Evropa", Basha fton qytetarët të jenë të shtunën në sheshin përballë Kryeministrisë në orën 19:00.
Tubimi pritet të jetë më i madhi i organizuar që nga nisja e protestave të mëdha të opozitës më 16 shkurt. Protesta e 25 majit vjen pas dhjetëra tubimesh kombëtare dhe protesta në çdo qytet të vendit, ku opozita kërkon largimin e kryeministrit Edi Rama, krijimin e një qeverie transitore dhe hapjen e rrugës për zgjedhje të parakohshme.
Të shtunën tubimi i qytetarëve pritet të jetë dhe më vendimtar për zgjidhjen e krizës politike në vend. Në kohën kur vendi është përfshirë nga konflikti i ashpër politik, kryeministri Edi Rama e ka përkeqësuar edhe më shumë situatën duke deklaruar se do të shkojë në zgjedhje vendore pa opozitën. Një skenar i tillë ka sjellë reagime të forta në gjithë shoqërinë shqiptare, duke e cilësuar fushatën elektorale pa opozitën si një vrasje të demokracisë dhe pluralizmit.
Tensionet politike janë shtuar nga java në javë pas përplasjeve të dhunshme mes qytetarëve dhe forcave të rendit, të cilat kanë përdorur gaz lotsjellës si dhe shkopinjtë e gomës ndaj qytetarëve. Zgjidhja e krizës duket ende larg për sa kohë që kryeministri Edi Rama jo vetëm nuk largohet nga detyra, por kërcënon me burg qytetarët që nuk do ta lejojnë mbajtjen e zgjedhjeve të organizuara vetëm nga një parti dhe ku në shumicën e 61 bashkive do të votohet vetëm për një kandidat.

## Presidenti Trump vë në shënjestër kandidatin demokrat Biden



UASHINGTON, 21 MAJ - Presidenti amerikan Donald Trump duket se po shfaq shqetësimin e tij lidhur me një rival të mundshëm që mund ta pengojë atë në rimarrjen e një mandati të dytë për Shtëpinë e Bardhë.
Presidenti Trump iu drejtua mbështetësve në shtetin e Pensilvanisë, vendlindja e kandidatit që kryeson fushatën demokrate, ish-nënpresidentit Joe Biden, i cili, gjithashtu, ka shërbyer si senator i shtetit Delauere. "Mos harroni, Biden ju braktisi. Ai lindi në Pensilvani dhe u largua nga këtu. Ju la ju për një shtet tjetër. Mbani mend këtë, desha të them se ai shprehet sikur e njeh qytetin Scranton, thotë se i njeh vendet më mirë. Ju braktisi ju për një shtet tjetër dhe nuk u kujdes për ju sepse nuk u kujdes për punësimin tuaj. Ai la vendet e tjera të vijnë dhe ta plaçkitin Amerikën", tha ai.
Trumpi dhe kandidati Biden e kanë vënë Pensilvaninë në qendër të përpjekjeve të tyre për t'i fituar zgjedhjet presidenciale të vitit 2020.
Bideni ka thënë se nëse "populli amerikan dëshiron një president që t'i thellojë ndasitë tona, të udhëheqë me një grusht të fuqishëm, dorë shtrënguar dhe me zemër të ngurtë", ata mund të votojnë për Trumpin.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të veçantë për ta shënuar 20-vjetorin e masakrës në Burgun e Dubravës

# Kuvendi kërkon drejtësi për masakrën e Dubravës



Me rastin e shënimit të 20-vjetorit të masakrës në Burgun e Dubravës, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë mbajtur një seancë të veçantë në të cilën kanë kërkuar dënimin e kryerësve të këtij krimi. Ata kanë thënë se masakra e Dubravës është një nga krimet më të dokumentuara meqë ka shumë fakte, dëshmi dhe dëshmitarë të gjallë. Deputetët, njëherësh të mbijetuarit e kësaj masakre, përveç bashkësisë ndërkombëtare, kanë kritikuar edhe institucionet vendore që nuk kanë bërë asgjë për zbardhjen e kësaj masakre dhe ndëshkimin e kriminelëve

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 MAJ - Kuvendi i Republikës së Kosovës të martën ka mbajtur seancë të veçantë për shënimin e 20-vjetorit të masakrës në Burgun e Dubravës që është një nga masakrat më të mëdha të kryera nga Serbia në Kosovë.

Deputetët të cilët i kanë mbijetuar kësaj masakre, duke rrëfyer tmerrin e përjetuar dy dekada më parë, kanë shprehur pakënaqësinë ndaj institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtarë që nuk kanë arritur t'i ndëshkojnë kryerësit e kësaj masakre. I mbijetuari i masakrës së Dubravës, deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Nait Hasani, ka thënë se kjo masakër ka qenë e planifikuar mirë që nga urdhërdhënësit e deri te gardianët.

Ai ka theksuar se ajo çfarë ka ndodhur në Dubravë nuk ka mundësi të shihet as në filma. "Kërkojmë të trajtohet një nga masakrat më të tmerrshme të ndodhura në vitin 1999 në Burgun e Dubravës nga gardianët dhe të burgosurit serbë mbi të burgosurit shqiptarë. Qëllimi i masakrës ka qenë i planifikuar mirë dhe këtë e dëshmon mbledhja e të burgosurve shqiptarë në Burgun e Dubravës", është shprehur Hasani, duke shtuar se për masakrën e Dubravës kanë ngritur kallëzim penal në Prokurorinë e Pejës më 19 janar 2007.

Megjithatë, ai ka thënë se dy dekada më pas asnjë qeveri nuk ka bërë asgjë për ndëshkimin e kriminelëve. "Deri më sot askush nuk ka çarë kokën për Burgun e Dubravës, asnjë qeveri e jona. Për këtë masakër nuk ka çarë kokën as Prokuroria e Pejës për 12 vjet prej kur është bërë publik kallëzimi penal më 19 janar të vitit 2007. Kërkoj nga ministri i Drejtësisë të japë shpjegim pse është heshtur ky krim dhe kush ka ndikuar. Kjo heshtje do të thotë të bësh krim për së dyti", ka deklaruar Hasani.

Ai ka adresuar edhe çështjen e zhdukjes së veprimtarit Ukshin Hoti i cili ka qenë i burgosur në Dubravë dhe që nga viti 1999 nuk dihet për fatin e tij.

I mbijetuari tjetër i masakrës së Dubravës, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Liburn Aliu, ka thënë se masakra në Burgun e Dubravës është një nga krimet më të dokumentuara meqë ka shumë fakte, dëshmi dhe dëshmitarë të gjallë. "Faktet janë grumbulluar, dëshmitë janë dhënë, janë botuar libra, madje janë bërë edhe dokumentarë. Ata që përjetuan dhe mbijetuan masakrën pjesën e tyre të punës e kryen si duhet. Të gjitha këto dëshmi u grumbulluan dhe u botuan, madje u bë edhe një kallëzim penal nga Shoqata e të Burgosurve Politikë. Por, këtu ngeci drejtësia. Nuk u bë aktakuza dhe kjo bie në përgjegjësi të shtetit dhe të autoriteteve ndërkombëtare", është shprehur Aliu, duke shtuar se Kosova ka dështuar të vë drejtësi. "Serbia nuk priti që këtë t'ia bëjnë ndërkombëtarët, e bëri vetë, trilloi dhe nuk u ndal së trilluari dhe hartuari padi ndaj nesh. Neve nuk na shfajëson në asnjë moment arsyetimi se pritëm që gjatë këtyre viteve ta bëjnë punën e tyre ndërkombëtarët. Të marrim masa konkrete si përmes ligjeve, po ashtu edhe përmes riaktivizimit të Institutit, si me ndërtimin e ekipeve në të gjitha nivelet e drejtësisë që do ta bëjnë punën e tyre. Në këtë aspekt, nuk duhet të dështojmë më", është shprehur Aliu.

Edhe i mbijetuari tjetër i masakrës në Burgun e Dubravës, deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Rasim Selmanaj, ka deklaruar se kjo masakër është kryer me urdhër të Qeverisë se Serbisë. Duke rrëfyer tmerrin e përjetuar, ai ka theksuar se masakra në Dubravë paraqet krim kundër njerëzimit. "Atë ditë po përjetonim torturat më të rënda të njerëzimit. Këto të fundit ishin të paimagjinueshme për mendjen e njeriut. Serbia e kishte arritur qëllimin e mbledhjes së shumicës të burgosurve në këtë burg. Maskara në Burgun e Dubravës në rend të parë paraqet krim kundër njerëzit", ka thënë Selamanaj, duke shtuar se bashkësia ndërkombëtare duhet t'i ndëshkojë ose t'i shpallë heronj kriminelët e Serbisë që kryen masakra. "Moszbardhja e këtij rasti është dëshpëruese. Kriminelët e Serbisë, tani bashkësia ndërkombëtare, ose duhet t'i ndëshkojë ose t'i shpallë heronj", ka deklaruar Selmanaj.

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se tani është koha të kërkohet drejtësi nga Serbia për masakrën e Dubravës dhe masakrat e tjera. Ai ka deklaruar se familjarët e viktimave me të drejtë mund të jenë të hidhëruar për moszbardhjen e krimeve serbe në Kosovë. "Ne mund ta dëmtojmë njëri-tjetrin se kjo është pjesa më e lehtë, por tani është koha ta drejtojmë gishtin kah Serbia dhe të kërkojmë drejtësi. Është në nderin e institucioneve të Kosovës që ta drejtojnë gishtin te kriminelët të cilët i kanë kryer këto krime dhe të marrim masa institucionale të cilat nuk na bëjnë ne një shoqëri vajtuese e përkujtuese, por na bëjnë një shtet veprues që kërkon drejtësi dhe e vendos drejtësinë në vend", ka deklaruar Veseli.

Ndërsa deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Mirjeta Kalludra, ka thënë se masakra e Dubravës është simbol i zi i veprimeve çnjerëzore të Serbisë në Kosovë. Ajo ka deklaruar se tani institucionet e drejtësisë duhet ta zbardhin këtë rast. "Masakra e Dubravës mbetet një akt i rëndë, tipik për një aparat shtetëror kriminal. Në emër të LDK-së shprehim solidaritetin me të mbijetuarit dhe familjet e viktimave si dhe kërkojmë që drejtësia të vihet në vend", është shprehur Kalludra.

Kurse shefi i grupit parlamentar i Nismës Social Demokrate, Bilall Sherifi, ka thënë se një nga provat e gjenocidit serb në Kosovë është edhe masakra në Burgun e Dubravës. Sipas tij, asnjëherë nuk është vonë për të zbardhur të vërtetën dhe dënuar krimin. "Një nga provat e gjenocidit serb është edhe masakra e Dubravës dhe dëshmitarët e saj janë edhe disa deputetë. Jemi vonuar si politikanë, por nuk është vonë sepse të jemi vonë është gjë tjetër prej asaj që ne jemi vonuar. Asnjëherë nuk bëhet vonë. Bile për ta ndjekur krimin e gjenocidit tani është koha", ka deklaruar Sherifi.

Ndërkaq deputetja Duda Balje nga grupi parlamentar 6+ ka thënë se për masakrën e Dubravës duhet të ketë drejtësi. "Masakra e Dubravës e ka një karakteristikë të veçantë duke marrë parasysh se janë vrarë nga ata që janë mbyllur e që është dashur t'i ruajnë. Drejtësia do të ndodhë dhe mburrem me ju", ka thënë ajo. Në këtë seancë kanë marrë pjesë të mbijetuarit dhe familjarët e viktimave të masakrës në Burgun e Dubravës.

Flet për "Epokën e re", Jakup Krasniqi

# Të jemi të bashkuar në raport



Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, e ka ftuar spektrin politik të jetë i bashkuar në raport me gjenocidin serb në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ka shumë arsye që faktori politik shqiptar për këtë çështje duhet të jetë i bashkuar. Sipas tij, askujt nuk i takon të deklarohet se mund apo nuk mund të themelohet tribunali ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Krasniqi ka thënë se institucionet e Kosovës duhet të punojnë në këtë drejtim. "Iniciativa mund të jetë një vrap për merita apo ndonjë arsye tjetër. Në këtë rast nuk duhet të merrem me gjëra të tilla. Një gjë dihet, krimet e gjenocidit serb nuk janë dënuar, ato duhet të dënohen. Kjo është ajo që duhet të merremi vesh jo vetëm ne në Kosovë, por edhe drejtësia ndërkombëtare", është shprehur Krasniqi

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 21 maj** - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka bërë me dije se askujt prej partive politike nuk i takon që të deklarohet se mund apo nuk mund të themelohet tribunali ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Ai ka thënë se spektri politik shqiptar duhet të jetë unik rreth gjenocidit serb në Kosovë dhe themelimit të tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi i ka ftuar institucionet e Kosovës që të punojnë në këtë drejtim. "Është e vërtetë se Kosova ka pak mundësi për të ndikuar në themelimin e kësaj gjykate për dënimin e krimit të gjenocidit të kryer në Kosovë gjatë vitit 1998/99. Por, kjo nuk do të thotë se ka ndonjë alibi, që institucionet e Kosovës mos të punojnë për krijimin e dëshmive se: Serbia në Kosovë ka kryer krime të gjenocidit, se kriminelët jo vetëm që shëtitën të lirë, por drejtuesit e shtetit serb jo vetëm se nuk janë penduar e kërkuar falje për këtë, por ata kërkojnë edhe t'i mohojnë krimet e gjenocidit. Pra, ka shumë arsyeje që faktori politik shqiptar, pozitë-opozitë, për këto çështje duhet të jetë në unison të plotë", ka thënë Krasniqi. Ai ka vlerësuar se iniciativat e tilla do të duhej të kishin një përgatitje para se të dilnin në opinion. "Iniciativa mund të jetë një vrap për merita apo ndonjë arsye tjetër, në këtë rast nuk duhet të merrem me gjëra të tilla. Një gjë dihet, krimet e gjenocidit serb nuk janë dënuar, ato duhet të dënohen. Kjo është ajo që duhet të merremi vesh jo vetëm ne në Kosovë, por edhe drejtësia ndërkombëtare", është shprehur ai.

Ish-kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ka treguar se nëse nuk arrihet themelimi i një tribunali ndërkombëtar, atëherë institucionet e Kosovës duhet t'i dënojnë krimet serbe. "Ato duhet ta kryejnë përgjegjësinë e tyre institucionale. Duhet ta ndjekin rrugën e Kuvendit i cili miratoi rezolutën me të cilën, politikisht dënon krimet e gjenocidit serb. Pas këtij akti duhet të miratohet Ligji për dënimin e kryerësve të krimit të gjenocidit në mungesë. Kjo i mbetet sistemit të drejtësisë në Kosovë. E pastaj vijnë veprimet e tjera. Këtë askush nuk mund t'ia mohojë Kosovës", ka thënë Krasniqi.

**"Epoka e re":** *Z. Krasniqi, 20 vjet pas luftës Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën për gjenocidin serb në Kosovë. Tani po diskutohet për mundësinë e themelimit të një tribunali ndërkombëtar për krimet e luftës. Si i kemi parë këto iniciativa?*

**Krasniqi:** Opinioni ynë duhet ta

# me krimet serbe në Kosovë



dijë se, veç problemeve që nuk janë varur nga ne, ka ekzistuar e vazhdon të ekzistojë një problem brenda politikës e shoqërisë shqiptare në përgjithësi. Dhe ky/këto probleme ishin e vazhdojnë të jenë: mungesa e debatit dhe e komunikimit në politikën tonë, mosharmonizimi i politikave të interesit kombëtar. Nuk kam asnjë fije dyshimi, që pengesat kryesore kanë ardhur deri më tani nga kryetarët e partive politike të cilët si dje ashtu edhe sot kanë diktuar me partitë politike. Kjo logjikë, për fat të keq, po vazhdon edhe sot e kësaj dite. Vazhdimi me këtë logjikë nuk mund të sjellë rezultate të tjera, veç atyre që i kemi parë e, fatkeqësisht, po i shohim edhe tani. Iniciativat e tilla do të duhej të kishin një përgatitje, mbase para se të dilnin në opinion. Iniciativa mund të jetë një vrap për merita apo ndonjë arsyeje tjetër, në këtë rast nuk duhet të merrem me gjëra të tilla. Një gjë dihet, krimet e gjenocidit serb nuk janë dënuar, ato duhet të dënohen. Kjo është ajo që duhet të merremi vesh jo vetëm ne në Kosovë, por edhe drejtësia ndërkombëtare.

**"Epoka e re":** *Dy partitë më të mëdha opozitare, LDK-ja e LV-ja, të hënën lëshuan sallën e Kuvendit ku po diskutohej për krijimin e një komisioni për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Cili është vlerësimi juaj për këto veprime?*

**Krasniqi:** Partitë opozitare mund edhe t'i kenë arsyet e tyre, që mua nuk më janë të panjohura, mund të kenë edhe ndonjë argument, gjithnjë sipas tyre por, për mua, nëse kihet parasysh rëndësia që ka për Kosovën e qytetarët tanë dënimi i krimit të gjenocidit, largimi nga Kuvendi është gabim dhe nuk është dashur të ndodhë. Kësaj i thonë: "Për inat të resë me vdektë djali!" Kjo logjikë na lë në labirintin pa shtegdalje.

**"Epoka e re":** *Me veprime të tilla a rrezikohet që të dërgohen mesazhe se Kuvendi i Kosovës nuk është unik as për krimet serbe në Kosovë?*

**Krasniqi:** Mesazhe të tilla Kuvendi i Kosovës në opinion përcjell përditë. Krejt çështja është, si t'i dallojmë ato gjëra që janë të interesit partiak e cilat janë ato të interesit kombëtar. Sikur po harrojmë që partitë politike janë formuar për t'i mbrojtur e avancuar interesat kombëtare e jo e kundërta. Madje tek ne shkohet edhe përtej kësaj që u tha, gjithçka iu nënshtrohet interesave të individit (njëshave të partive politike). Një gjë duhet që ta dimë, partitë tona, anëtarësitë e partive tona dhe të gjithë qytetarët tanë duhet që ta dinë se pa u liruar nga despotet (të gjithëpushtetshmit) e partive politike, logjika e sundimit nuk do të kthehet në logjikë të qeverisjes demokratike.

**"Epoka e re":** *Pretendimet e LDK-së dhe të LV-së ishin se ky tribunal nuk mund të bëhet. Sa sfiduese për Kosovën do të jetë që të arrijë ta bindë bashkësinë ndërkombëtare për themelimin e një tribunali të tillë?*

**Krasniqi:** Ne konsiderojmë se asnjë partie politike veç e veç, as marrë së bashku, nuk i takon të deklarohet mund apo nuk mund të bëhet një gjykatë që do të merret me dënimin e krimeve të gjenocidit serb. Është e vërtetë se Kosova ka pak mundësi për të ndikuar në themelimin e kësaj gjykate për dënimin e krimit të gjenocidit të kryer në Kosovë gjatë vitit 1998/99, por kjo nuk do të thotë se ka ndonjë alibi, që institucionet e Kosovës mos të punojnë për krijimin e dëshmive se: Serbia në Kosovë ka kryer krime të gjenocidit, se kriminelët jo vetëm se shëtitën të lirë, por drejtuesit e shtetit serb jo vetëm se nuk janë penduar e kërkuar falje për këtë, por ata kërkojnë edhe t'i mohojnë krimet e gjenocidit. Pra, ka shumë arsyeje që faktori politik shqiptar, pozitë-opozitë, për këto çështje duhet të jetë ë bashkuar.

**"Epoka e re":** *Nëse nuk arrihet të themelohet ky tribunal, çfarë duhet të bëjnë institucionet e Kosovës për ta vendosur drejtësinë për krimet e luftës në vend?*

**Krasniqi:** Çka duhet të bëjnë institucionet e Kosovës? Ato duhet ta kryejnë përgjegjësinë e tyre institucionale. Duhet ta ndjekin rrugën e Kuvendit i cili miratoi rezolutën me të cilën, politikisht dënon krimet e gjenocidit serb. Pas këtij akti duhet të miratohet Ligji për dënimin e kryerësve të krimit të gjenocidit në mungesë. Kjo i mbetet sistemit të drejtësisë në Kosovë. pastaj vijnë veprimet e tjera. Këtë askush nuk mund t'ia mohojë Kosovës.

# Ministri Tahiri: Askush s'do të mund ta përdorë pasurinë e fituar nga kriminaliteti

Prishtinë, 21 maj (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka marrë pjesë në tryezën nacionale "Përmirësimi i garancive procedurale në procedurën e mbrojtjes penale lidhur me 'Pastrimin e parasë, sekuestrimit dhe ngrirjes së pasurisë në Kosovë'" të organizuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Me këtë rast, ai ka përmendur agjendën e ngjeshur legjislative që është plotësuar për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nisur nga Kodi i ri Penal, Draft Kodi i Procedurës Penale si dhe Ligji i ri për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së fituar me vepër penale. "Kemi pasur debat të ngjeshur rreth përcaktimit mbi modelin e konfiskimit dhe pas muajve të tërë të ballafaqimit të koncepteve, me ndihmën edhe të partnerëve tanë zhvillimorë, ia kemi arritur të ndërtojmë një bazë ligjore të fuqishme e cila do ta rrisë efikasitetin e organeve të pavarura të zbatimit të ligjit. Dispozitat e këtij ligji janë të ndërtuara me përmbajtje të tillë që të eliminojnë çdo paqartësi, zbrazëti ligjore apo dualizëm të normave ligjore në kuadër të legjislacionit të fushës", ka thënë ministri Tahiri.

Ai ka përmendur veprat penale për të cilat zbatohet konfiskimi i pasurisë, që nga krimi i organizuar, korrupsioni, veprat penale kundër shëndetit publik, të trafikimit me njerëz, skllavërisë dhe rrëmbimit, ato që lidhen me konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit si dhe veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.




Shkalla e sekuestrimit të pasurisë së fituar nga veprat penale, sipas ministrit Tahiri, është relativisht e mirë, por ajo e konfiskimit përfundimtar është vazhdimisht e pamjaftueshme.

Ministri Tahiri ka theksuar se shoqëria do të vuajë nga pabarazia, thyerja e besimit në institucione dhe nga imazhi i keq i vendit, kurse mjetet e fituara nga krimi mbesin në dispozicion të aktorëve të krimit të organizuar. "Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit më së miri fitohet kur ua pamundësojmë përdorimin e aseteve të fituara nga to. Kjo është fryma përmes së cilës i kemi dhënë drejtim vendosmërisë sonë për ta luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe keqpërdorimin. Ka qenë shumë e nevojshme që si shtet dhe si shoqëri të dërgojmë një mesazh të fuqishëm se askush s'do të mund të përfitojë jashtëligjshëm dhe askush s'do të mund ta përdorë pasurinë e fituar nga kriminaliteti", ka thënë ministri Tahiri.

# Të plagosurit para luftës kërkojnë të barazohen me invalidët



PRISHTINË, 21 MAJ - Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka diskutuar për statusin e personave të plagosur në Kosovë, para periudhës së luftës. Përfaqësues i Shoqatës së të Plagosurve në demonstrata para luftës, Naim Zhitia, ka thënë se ata kërkojnë t'u njihet kontributi i të plagosurve në demonstrata, duke hyrë në një nivel me kategoritë e invalidëve të luftës.

Ndërsa Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, ka thënë se ka nevojë për plotësim ndryshim të ligjit. "Këto kategori nuk janë përfshirë në përkufizimet e ligjit dhe të gjitha kategorive të tjera u njihet e drejta e kontributit të luftës. Ky ligj ka pësuar ndryshme ku janë përfshirë edhe personat e dhunuar gjatë kohës së luftës. Një prej opsioneve, nëse ekziston vullneti politik, duhet të bëhet një plotësim i ligjit për kategori të këtyre personave", ka thënë Jashari.

Naser Behrami, i plagosur gjatë kohës së luftës, ka thënë se duhet t'u njihet kjo e drejtë legjitime pasi, sipas tij, plagët e invalidëve kanë vlerën e saj. "Ne kemi menduar që kemi shtet dhe institucione dhe na përfshijnë në ligj si persona të plagosur. Kemi menduar se do të na përfshijnë në të drejtat tona dhe mendoj se kjo duhet të ndodhë. Prej pasluftës e gjithë situata ka filluar mbrapsht. Ne nuk duam as më shumë e as më pak, vetëm të njihemi si kategori sipas ligjit. Kërkojmë nga ky komision që të na njihet kjo e drejtë e jona legjitime, sepse plagët e invalidëve kanë vlerën e saj dhe ne nuk kërkojmë asgjë më shumë vetëm që të na njihet e drejta jonë", ka thënë Behrami. Kjo kategori e këtyre personave mori edhe përkrahjen e anëtarëve të këtij komisioni.

# MBPZhR-ja hap periudhën për aplikim për grantet investive në bujqësi



PRISHTINË, 22 MAJ (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që nga e marta ka hapur periudhën për aplikim për disa nga masat mbështetëse për këtë vit përmes granteve investive për fermerët në gjithë territorin e Kosovës. Buxheti për këto masa për zhvillim rural këtë vit arrin në 20,500,000.00 euro.

Thirrjet për aplikim janë hapur për masën 101, përmes së cilës përkrahen investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore, për masën 103 përmes së cilës përkrahen investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore, për masën 302 përmes së cilës përkrahen investimet në diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e bizneseve, për masën e ujitjes së tokave bujqësore, për masën 303, përmes së cilës përkrahen investimet në përgatitjen dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal - qasja Leader për grupet lokale të veprimit (GLV) të përzgjedhura.

Gjatë periudhës për aplikim, e cila është hapur më 22 maj e që zgjatë deri më 1 korrik 2019, fermerët dhe agrobizneset mund të aplikojnë për të përfituar në kuadër të këtyre masave, duke u bazuar në dokumentacionin, procedurat dhe kriteret e parapara me program dhe që janë publike në faqen e ministrisë dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB). Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, fermerët dhe agrobizneset do të mund t'i gjejnë në uebfaqen e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, www.azhb-ks.net dhe në uebfaqen e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural www.mbpzhr-ks.net. Po ashtu, ata mund të informohen edhe në Zyrat Rajonale të AZhB-së.

# Komiteti për komunitete kërkon të ndihmohen disa familje për festën e bajramit në Malishevë

MALISHEVË, 21 MAJ (ER) - Komiteti për Komunitete në Komunën e Malishevës ka mbajtur mbledhjen e pestë të rregullt të cilën e ka kryesuar kryesuesja Hidajet Mazreku. Ndër pikat e shqyrtuara ishte edhe pika që u debatua për t'i ndihmuar disa familje të komunitetit rom, me shportën ushqimore, pikërisht me përfundim të muajit të shenjtë të Ramazanit, si dhe u kërkua të janë prioritet studentët nga ky komunitet për mbështetje financiare nëse janë vijues të studimeve. Tërë kjo mbështetje do të shkojë përmes Zyrës për Komunitete të Komunës së Malishevës, Komitetit për Komunitete, brenda buxhetit, që u është ndarë për vitin 2019.



# Klinika e Alergologjisë së shpejti me hapësira të reja

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Alergologjia me Imunologji do të ofrojë shumë shpejt kushte për hospitalizim të pacientëve, pasi të vendoset në katin përdhes, në ambientet ku më herët ofronin shërbime ambulancat specialistike të internos. "Në mungesë të hapësirave aktualisht funksionon si shërbim ambulator në objektin e instituteve, në të cilin zhvillohen veprimtari arsimore, kërkimore-shkencore. Punimet e vrazhda janë në fazën përfundimtare", është thënë në njoftimin e QKUK-së. Ky institucion ka njoftuar se, sipas planifikimeve, procesi i punës në renovimin e hapësirave do të përfundojë shpejt, ndërsa klinika do ta fillojë punën aty brenda pak muajsh. Investimet janë pjesë e një projekti që ka nisur para një viti, me qëllim të modernizimit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.



# Provimi i maturës shtetërore mbahet më 12 dhe 15 qershor

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë vendim për caktimin e datave të mbajtjes së provimit të Maturës Shtetërore 2019 në afatin e qershorit. Sipas këtij vendimi, maturantët do t'i nënshtrohen pjesës së parë të provimit të maturës nga data 12.06.2019 deri më 15.06.2019, ndërsa pjesa e dytë e provimit do të mbahet nga data 19.06.2019 deri më 22.06.2019. Provimi i Maturës Shtetërore do të mbahet në katër lëndë, tri lëndë obligative dhe një lëndë me zgjedhje. Tërheqja publike e shortit për renditjen e mbajtjes së testit nëpër regjione bëhet më 6 qershor 2019.



# Jahjaga thotë se korrupsioni po ngulfat Kosovën

Korrupsionin është një nga pengesat kryesore për zhvillimin demokratik, ekonomik dhe social të Republikës së Kosovës. Kështu ka deklaruar ish-presidentja e vendit, Atifete Jahjaga, në debatin e organizuar të martën nga Lëvizja FOL. Ajo ka thënë se Kosova është duke u ngulfatur nga nepotizmi, klientelizmi, punësimet mbi baza partiake dhe politike, keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe format e tjera të korrupsionit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 MAJ - Ish-presidentja e shtetit të Kosovës, Atifete Jahjaga, të martën ka marrë pjesë në debatin e organizuar nga Lëvizja FOL, me temë "Pjesëmarrja e gruas në politikë dhe se a do të luftohej më shumë korrupsioni me pjesëmarrje më të madhe të gruas në pozita vendimmarrëse". Në këtë debat, në të cilin ishin të pranishëm edhe disa studentë, ish-presidentja Jahjaga ka shprehur qëndrimet për problemet me të cilat është duke u përballur vendi ynë. Me këtë rast, ajo ka vlerësuar se korrupsioni është një nga pengesat kryesore për zhvillimin demokratik, ekonomik dhe social të Republikës së Kosovës. Sipas Jahjagës, nepotizmi, klientelizmi, punësimet mbi baza partiake dhe politike, keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe format e tjera të korrupsionit janë duke e ngulfatur shtetin e Kosovës.

Po ashtu, ish-presidentja Atifete Jahjaga ka theksuar rëndësinë për raportimin e rasteve të korrupsionit nga qytetarët dhe luftimin e tij nga autoritetet e drejtësisë. Sipas Jahjagës, Kosova si asnjëherë më parë ka nevojë për ndryshim pozitiv. "Korrupsioni është një nga pengesat kryesore për zhvillimin demokratik, ekonomik dhe social të Kosovës. Është i rëndësishëm raportimi i rasteve të korrupsionit nga qytetarët dhe luftimi i tij nga autoritetet e drejtësisë. Nepotizmi, klientelizmi, punësimet mbi baza partiake dhe politike, keqpërdorimi i detyrës zyrtare dhe forma të tjera të korrupsionit të shprehura në Kosovë, ngufasin vendin tonë dhe bllokojnë të gjitha përpjekjet për ndryshim pozitiv. Kosova sot, si kurrë më parë, ka nevojë për ndryshim pozitiv", ka deklaruar ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, në debatin e organizuar nga Lëvizja FOL.



# Hoxhaj me ndihmësministrin e Jashtëm kroat flasin për një rol edhe më të madh të Kroacisë në rajon



PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka pritur të martën në takim një delegacion kroat, i udhëhequr nga ndihmësministri i Jashtëm, Miroslav Papa.

Në takim zëvendëskryeministri Hoxhaj ka falënderuar Kroacinë për mbështetjen e vazhdueshme në të gjitha fazat e shtetndërtimit, para dhe pas shpalljes së pavarësisë. Po ashtu, është diskutuar edhe për bashkëpunimin konkret në disa fusha, veçmas në atë ekonomike dhe tregtare. "Kroacia është një prej vendeve mike më të mëdha të Kosovës në rajon. Mbështetja kroate ka qenë e vazhdueshme jo vetëm në aspektin bilateral, por edhe atë rajonal, duke qenë edhe vend anëtar i BE-së. Diskutuam sot për mundësitë e bashkëpunimit më të madh në fushën ekonomike dhe tregtare, meqë marrëdhëniet politike janë të shkëlqyera. Muajt e fundit ka një dimension të ri në këto raporte dhe duam që Kroacia të ketë një përkushtim dhe rol edhe më të madh", ka thënë zëvendëskryeministri Hoxhaj.

Është diskutuar edhe për mbështetjen e Kroacisë për anëtarësimin e Kosovës në disa organizata rajonale dhe procesin e eurointegrimeve.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka theksuar nevojën që BE-ja duhet të marrë një vendim sa më parë për vizat dhe që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut ta marrin dritën e gjelbër për t'i hapur negociatat.

## U përurua ura e fshatit Topanicë

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Të martën ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka marrë pjesë në përurimin e urës së fshatit Topanicë në Komunën e Kamenicës. Lekaj ka theksuar se përfundimi dhe hapja e kësaj ure është kryer falë angazhimit të MIT-së dhe bashkëpunimit me Komunën e Kamenicës dhe se në këtë mënyrë janë plotësuar nevojat të cilat e bëjnë këtë vend dinjitoz.

Kjo urë me kosto prej 210 mijë eurosh është përfunduar në kuadër të projekteve të nivelit qendror dhe, si e tillë, luan një rol tejet të rëndësishëm për banorët e këtij fshati, ngaqë ndërtimi i kësaj ure ka qenë kërkesë e kamotshme e tyre.

MIT-ja mbetet e angazhuar edhe më tutje që, përveç projekteve qendrore, të ndihmojë edhe në realizimin e projekteve lokale, aty ku me të vërtetë është e nevojshme për qytetarët.



# Apostolova: Vetëm 10 për qind e bizneseve janë në pronësi të grave

PRISHTINË, 21 MAJ - Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë të martën se, derisa mbi 50 për qind e popullsisë së Kosovës përbëhet nga femrat, vetëm 10 për qind e bizneseve në Kosovë janë pronësi e grave. Këtë deklaratë Apostolova e bëri me rastin e publikimit të raportit "Kuota gjinore në bordet e korporatave në Kosovë".
Ajo ka ftuar gratë që ta marrin pushtetin që u takon, përfshirë edhe fushën e ndërmarrësisë. "Vetëm 10 për qind e bizneseve në Kosovë janë në pronësi të femrave. Zyra e BE-së në Kosovë çdo ditë mbështet zbutjen e hendekut të pabarazisë mes femrave dhe meshkujve në fushën e ndërmarrësisë. Projekti ERAC, i nxjerrë nga BE-ja, është tema e prezantimit të sotëm. Kuotat nuk janë çdo gjë. Kuotat kanë bërë përmirësim në përfaqësimin e femrave kudo që janë përfaqësuar. Femrat përfaqësojnë më shumë se 50 për qind të popullsisë të Kosovës, dhe mu për këtë ato duhet ta marrin pushtetin që u takon edhe në fushën e ekonomisë", ka thënë Apostolova.




# Kosova ka arritur përparim të kënaqshëm për menaxhimin e financave publike

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Ministria e Financave ka mbajtur të martën takimin e Dialogut të Politikave të Menaxhimit të Financave Publike (MFP), ku të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësuesit e institucioneve të Qeverisë së Kosovës, përfaqësuesit e Komisionit Evropian, partnerët e tjerë ndërkombëtarë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile me të cilët kanë diskutuar për progresin, por edhe për sfidat për zbatimin e Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2016-2018.
Në këtë takim, i cili kryesohej nga zëvendësministri i Financave, Fatmir Gashi, u diskutua për raportin vjetor 2018 të Progresit të Implementimit të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2016-2020, ku nga të pranishmit u cilësua si një e arritur. "Për sa i përket raportit vjetor 2018 të progresit të implementimit të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2016-2018, përgatitja e tij ka qenë një kombinim i takimeve dhe konsultimeve brenda GK për MFP dhe konsultimeve me palët ndërinstitucionale dhe me palët e tjera të interesit. Përfundimisht ka kaluar edhe diskutimin në Takimin e Këshillit Ministror për Reformën e Administratës Publike (KMRAP). Raporti është bazuar në planin e veprimit dhe pasaportën e indikatorëve, duke raportuar në nivel të prioriteteve bazuar në indikatorë", ka thënë zëvendësministri Gashi.



Ai ka bërë me dije se ky raport i tretë vjetor përmbledh dhe paraqet arritjen e prioriteteve dhe përparimin në aktivitete të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) gjatë vitit 2018. "Hartimi i raportit monitorues vjetor ka për qëllim shqyrtimin e progresit të arritur në zbatimin e strategjisë si dhe identifikimin e sfidave dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese. Raporti i tretë vjetor i zbatimit të Strategjisë për Reformën e MFP evidenton progres të kënaqshëm", ka thënë Gashi.

# Reçica në Portugali takon homologun e vet, pajtohen për bashkëpunim



PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, po qëndron në një vizitë zyrtare në Lisbonë të Portugalisë.
Reçica, i shoqëruar nga ambasadori i Kosovës në Portugali, Ylber Kryeziu, ka takuar ministrin e Punës, Solidaritetit dhe Sigurimit Social, Jose Vieira da Silva, të cilin e ka njoftuar rreth gjendjes socio-ekonomike në Kosovë dhe problemeve me të cilat Kosova përballet sa i përket papunësisë. Nga homologu i tij, Reçica është njoftuar rreth sistemit të avancuar të aftësimit dhe riaftësimit profesional në Portugali dhe rëndësisë që shteti portugez i jep trajnimit profesional të qytetarëve të saj.
Ministri Reçica ka thënë se qeveria, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është duke i kushtuar rëndësi të veçantë aftësimit profesional si parakusht për zbutje të papunësisë në vend. Ai ka shtuar se është shumë e rëndësishme që Kosova t'i përvetësojë nga Portugalia praktikat më të mira sa i përket punësimit, aftësimit dhe riaftësimit profesional, për çfarë ka kërkuar që të konkretizohet bashkëpunimi nëpërmjet një marrëveshje bilaterale në fushën e punësimit si dhe aftësimit profesional. Me këtë rast, Reçica e ftoi ministrin Jose Vieira da Silva që ta vizitojë Kosovën dhe ta shohin mundësinë e bashkëpunimit.

## Komuna e Mitrovicës paralajmëron masa të shtuara sigurie afër lumenjve dhe liqeneve

MITROVICË, 21 MAJ (ER) - Me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve parandaluese në ofrimin e sigurisë, në kuadër të implementimit të planit operativ "sezoni veror", me iniciativën e drejtorit për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Mitrovicës, Nehat Bahtiri, zyrtarët komunalë, së bashku me Policinë e Kosovës, kanë vizituar disa zona të lumenjve dhe liqeneve të cilat mund të paraqesin rrezik për qytetarët.
Gjatë inspektimit të këtyre zonave përfaqësuesit nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë vlerësuar se zonat me të rrezikuara janë përgjatë liqenit artificial, duke kërkuar të shtohet numri i shenjave të rrezikut dhe paralajmërimi për vizitorët me anë të shenjëzimeve dhe segmentet për thellësinë, rrymat e ujit si dhe rreziqet e tjera të mundshme.
Po ashtu, është kërkuar të bëhet edhe vendosja e pengesave (barrierave në afërsi të digave), për faktin se vrulli i ujit paraqet rrezik kryesisht për fëmijë. Me këtë rast, shefi i sektorit për Siguri dhe Emergjenca, Bahtir Maxhuni, ka thënë se këto objektiva parashihen të ndërmerren bazuar në planin e veprimit, me qëllim të krijimit të një ambienti të qetë dhe të sigurt në zonat e lumenjve dhe liqenit artificial, të cilat po frekuentohen nga një numër i madh i qytetarëve.
Përfaqësuesit komunalë kanë shprehur gatishmërinë për t'i



bashkërenduar aktivitetet për krijimin e kushteve dhe sigurisë si dhe u zotuan se brenda mundësive do t'i ndërmarrin masat e parapara për plotësimin e shenjave dhe barrierave.

Në Tiranë është mbajtur tryeza e organizuar nga Forumi Ekonomik Mbarëshqiptarë me temë "Mundësitë dhe sfidat e marrëdhënieve tregtare Kosovë- Shqipëri"

# Bëhet thirrje që Kosova dhe Shqipëria të bashkëpunojnë më fuqishëm në aspektin ekonomik

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, njëherësh koordinator kombëtar i dy qeverive, ka apeluar të martën në Tiranë, që bizneset e dy vendeve dhe qeveritë t'i gjejnë interesat e përbashkëta për ta eliminuar çdo pengesë burokratike. "Ne do të donim që bizneset tona t'i gjejnë interesat e përbashkëta dhe të bëjnë konsorciume për t'i synuar tregjet e treta", ka thënë Limaj, duke theksuar se koha e spektakleve ka përfunduar dhe të gjitha marrëveshjet e nënshkruara në mbledhjen e mbajtur në Pejë, deri në fund të muajit qershor, do të nisin së zbatuari




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Tiranë, 21 maj - Klubi i Prodhuesve të Kosovës, së bashku me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, Odën Ekonomike të Kosovës, Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë, të martën kanë organizuar tryezën e përbashkët "Mundësitë dhe sfidat e marrëdhënieve tregtare Kosovë-Shqipëri", e cila është mbajtur në kuadër të Forumit Ekonomik Mbarëshqiptarë. Kjo tryezë kishte për qëllim prezantimin dhe adresimin e sfidave dhe barrierave tregtare që prodhuesit e Kosovës dhe Shqipërisë po hasin gjatë tregtimit të produkteve të tyre në këto dy tregje, por edhe mundësitë dhe lehtësimet që u janë ofruar nga të dy qeveritë përkatëse.

I pranishëm në këtë tryezë ishte edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, njëherësh koordinator kombëtar i dy qeverive për mbikëqyrjen dhe zbatimin e marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Limaj ka apeluar që bizneset e dy vendeve dhe qeveritë t'i gjejnë interesat e përbashkëta për ta eliminuar çdo pengesë burokratike. "Ne do të donim që bizneset tona t'i gjejnë interesat e përbashkëta dhe të bëjnë konzorciume për t'i synuar tregjet e treta", ka thënë Limaj, duke theksuar se koha e spektakleve ka përfunduar dhe të gjitha marrëveshjet e nënshkruara në mbledhjen e mbajtur në Pejë deri në fund të muajit qershor do të nisin së zbatuari. Ai ka thënë se prej tash e sa vite është shndërruar në zëdhënës të prodhuesve vendorë pasi, sipas tij, fuqizimi i bizneseve vendore nënkupton zhvillim më të fuqishëm ekonomik dhe hapje të reja të vendeve të punës.

Limaj ka folur edhe për takimin koordinues mes dikastereve qeveritare përkatëse, me ç'rast ka kërkuar angazhim më të madh nga të dyja qeveritë. "Ne kemi pesë vendime që janë marrë në mbledhjen e Pejës. Të pesë marrëveshjet janë në realizim e sipër. Pas kësaj mbledhje kemi krijuar grupe punuese për të përcjellë sa po realizohen ato marrëveshje. Tani ka filluar njohja e patentëshoferëve. Sa i përket qarkullimit të qytetarëve në pikën kufitare Morinë - Vërmicë, kanë qenë disa probleme teknike për qarkullim të njerëzve në pikën kufitare dhe në bashkëpunim të ngushtë me ministritë përkatëse do t'i largojmë ato pengesa të cilat shkaktojnë telashe për të lëvizur", ka thënë Limaj.

Sa i përket marrëveshjes për njohje të certifikatave, ai ka bërë me dije se janë mbi 42 certifikata të cilat njihen në mënyrë reciproke dhe çdo certifikatë që lëshohet nga një agjenci në Tiranë dhe Prishtinë njihet anasjelltas.

Limaj ka folur edhe për pikën doganore në Durrës, për të cilën ka thënë se janë vërejtur disa probleme në funksionim dhe të cilat do të rregullohen brenda një periudhe të shkurtër. "Çështja e skanerit dhe taksa e rrugës. Kemi biseduar një kohë të gjatë për të parë si mund të dalim nga kjo situatë. Ne jemi të vetëdijshëm se Shqipëria ka obligime shtetërore, por ne mendojmë se për një vendim të keq të Kuvendit të Kosovës të mos vuajnë qytetarët e Kosovës dhe anasjelltas", ka shtuar Limaj.

Zëvendëskryeministri i Kosovës ka ftuar qeverinë shqiptare dhe shoqatat tregtare nga Shqipëria ta bëjnë listën nëse kanë ndonjë pengesë burokratike apo të çfarëdo natyre nga Kosova. "Ne ju ftojmë ta gjeni interesin e përbashkët dhe kompanitë të konkurrojnë në tregjet e treta. Shqetësimi im është klasifikimi. Korridori i TAP-it. Ne jemi të interesuar për rrjetin e klasifikimit që duhet bërë në Kosovë dhe Shqipëri", ka deklaruar Limaj.

Nagip Fejzi, kryetar i Forumit Ekonomik Mbarëkombëtar, ka thënë se është koha e duhur që faktori shqiptar t'i ndezë sinjalet e bashkëpunimit mbarëkombëtar dhe të fillojë integrimi i këtyre ekonomive në ekonomi komplementare. "Fuqia për zhvillim është slogani që mbartë ky forum dhe së bashku do të bashkohemi për zhvillim të të gjithë shqiptarëve në rajon" u shpreh ai.

Gjatë prezantimit të marrëdhënieve tregtare në mes të këtyre dy vendeve, u theksua se pengesat kryesore për prodhuesit kosovarë në eksport janë barriera jotarifore, ku në çdo eksport autoritetet shqiptare u kërkojnë kopjen origjinale (ose kopjen e noterizuar) të certifikatës së cilësisë për produktet që i nënshtrohen kontrollit fitosanitar dhe veterinar. Procedurat e zhdoganimit në Shqipëri, pagesa e skanerit, noterizimi i analizave, pagesa në rrugën e kombit, mosmarrja për bazë e çmimit të faturës nga Dogana Shqiptare, zbatimi i normës të lartë të akcizës janë disa prej pengesave të cilat e rrisin koston e prodhimit dhe e ulin nivelin e konkurrueshmërisë së produkteve të Kosovës në tregun e Shqipërisë.

Kryetari i Klubit të Prodhuesve, Fejzulla Mustafa, ka thënë se të gjitha bizneset që janë të pranishme në këtë takim do të duhej t'i shqyrtojnë mundësitë e bashkëpunimit. Ai ka përmendur shumë barriera tarifore dhe jotarifore të cilat prodhuesit i hasin në tregti me Shqipërinë, por me asnjë vend tjetër.

Të pranishëm në këtë tryezë ishin përfaqësues të bizneseve nga të dy vendet, por edhe përfaqësues nga të dy qeveritë.

## Ministrja e Bujqësisë dhe ambasadori britanik diskutojnë për projektet bujqësore

Prishtinë, 21 maj (ER) - Ministrja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Ziviq, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell, me të cilin kanë biseduar për proceset të cilat kanë ndodhur deri më tani për rimëkëmbjen e sektorit të bujqësisë.

Ministrja Ziviq me këtë rast ka falënderuar ambasadorin O'Connell për mbështetjen që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë në vazhdimësi Kosovës për zhvillimin e sektorëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe atë të bujqësisë.

Ajo, po ashtu, e ka njoftuar ambasadorin për investimet, të cilat planifikojnë t'i bëjnë në këtë sektor në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të këtij viti. Ministrja ka shprehur gatishmërinë e saj për ta thelluar edhe më tej partneritetin në mes të MBPZhR-së dhe Ambasadës së Britanisë së Madhe në Kosovë, me qëllim të fuqizimit të mëtejmë të sektorit të bujqësisë.

Ndërsa ambasadori Ruairi O'Connell e ka përgëzuar ministren për emërimin ministre e Bujqësisë dhe i ka uruar suksese për avancimin e projekteve bujqësore.



# Uniteti



Hysni GUCATI

Gjatë gjithë historisë, në çastet kyçe, elitat politike kanë kërkuar bashkim me spektrin e gjerë politik për t'i arritur qëllimet kombëtare. Në të gjitha rastet kur është arritur bashkimi, sukseset kanë qenë të pashmangshme.

Është e ditur se te popujt që kanë qenë të robëruar, problemet e brendshme janë të mëdha, por edhe përçarjet e krerëve të politikës janë evidente. Shumë gjëra të kësaj natyre i kemi trashëguar nga ish-sistemi okupues, madje një pjesë të asaj strukture e kemi të inkorporuar në administratë, në parti politike, në Kuvend, në vijat e biznesit, media e kudo tjetër në spektrin e politikëbërjes.

Ish-strukturat e UÇK-së, kur kanë ardhur në pushtet, e kanë amnistuar klasën e ish-sistemit, madje edhe nomenklaturën që ka qenë pjesë e pushtetit të kasapit të Ballkanit, Sllobodan Milloshevigit. Por kjo nuk ka qenë reciproke edhe nga ana e ish-klasës së sistemeve të ish-strukturave komuniste, por edhe të atyre që kanë qenë pjesë e pushtetit të Sllobodan Milloshevigit, të cilët u shndërruan në kundërshtarë dhe rivalë të papërmirësueshëm kundër strukturës së UÇK-së. Si pasojë e këtyre përplasjeve politike që janë bërë evidente, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, përplasjet mes këtyre dy grupimeve u bënë më të ashpra, madje filloi edhe një luftë e ashpër për pushtet.

Edhe përkundër vështirësive dhe pengesave të mëdha, qeveritë e deritanishme të Kosovës janë përpjekur për ta ndërtuar shtetin e Kosovës në bazë të mundësive dhe kapaciteteve që i kanë pasur ato. Pos vështirësive dhe ballafaqimeve me të panjohurat që kanë dalë pas shpalljes së Republikës së Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, më 17 shkurt 2008, qeveritë e Kosovës janë ballafaquar edhe me ndërhyrjet e vazhdueshme të shtetit të Serbisë dhe shteteve mike të saj, të cilat e kanë shantazhuar Kosovën skajshmërisht, i kanë sabotuar proceset, madje edhe në nivele ndërkombëtare, e kanë cenuar dhe rrezikuar sigurinë e Kosovës gjatë 365 ditëve të vitit.

Proceset komplotiste të disa qarqeve të caktuara janë bërë të dukshme. Ndoshta për këtë arsye pasivizimi i shtetësisë nga kjo klasë është bërë trend. Enklavizimi i Kosovës për ditë e më shumë po merr dimensione të reja. Disa komuna ka kohë që janë zhveshur nga kompetencat e ligjeve të Kosovës. Pos kësaj, disa vendbanime në territorin e Kosovës po emërohen me emra serbë. Uniteti është e vetmja armë përmes së cilës mund të tejkalohet kjo gjendje me shumë pak mundësi për rrugëdalje.

Brenga që ka pllakosur vendin tonë kohën e fundit, është ikja masive e të rinjve nga Kosova. Ky fenomen është vetëvrasje për vendin tonë. Prandaj, Qeveria e Kosovës është e obliguar për ta bërë një raport në të cilin duhet të ceken shkaqet e ikjes masive të të rinjve nga Kosova. Ikja e shqiptarëve nga vendet e tyre kohë më parë ka ndodhur edhe te shqiptarët në Çamëri, në Mal të Zi, Maqedoni, Kosovën Lindore etj. Këto vende janë zbrazur nga elementi shqiptar dhe kanë mbetur pothuajse të boshatisura. Këtë eksod kaq të madh nuk kanë mundur ta nxisin as luftërat, as masakrat e pafundme që i kanë bërë mbi këtë popullatë. Atëherë, pse po braktisen trojet shqiptare nga shqiptarët. I kujt është ky projekt. Projektuesit e këtyre planeve kaq antishqiptare po e shfrytëzojnë përçarjen tonë të brendshme, unitetin e brishtë, divergjencat ideologjike, fetare e ekonomike.

Forca e unitetit mungon në vendin tonë. Unë mendoj dhe apeloj që ta ruajmë dhe ta forcojmë unitetin. Uniteti kombëtar është arma më efektive me të cilën duhet t'i dalim përballë të gjitha projekteve të përgatitura antikombëtare. Mungesa e këtij uniteti i ka kthyer partitë dhe shtetin në vetëshërbim të tyre, në klientela familjare.

Qindra e mijëra dëshmorë nuk e dhanë jetën e tyre për të krijuar një shtet, që në mënyrë të paligjshme favorizon disa, duke zvogëluar shanset për të tjerët. Kjo çka po ndodhë për ditë me popullin tonë, është krim mbi të kaluarën dhe të ardhmen e këtij vendi.

Është domosdoshmëri që të fillojmë që sot të merremi me emancipimin kombëtar, sepse përmes këtij procesi arrijmë më shpejt tek uniteti kombëtar. Uniteti është fitore e të gjitha betejave dhe mekanizëm për t'i kaluar të gjitha sfidat që na dalin përpara.

Duhet ta dimë pse qytetarët e Kosovës po ikin nga liria të cilën e fituam me mund e sakrifica të mëdha. Sipas MPB të Kosovës, këto 5 vitet e fundit nga Kosova kanë ikur 170 000 banorë. Diku 10 për qind e popullsisë së përgjithshme. Sipas Agjencisë së statistikave, më 1 janar 2017, Kosova kishte rreth 1,78,531 banorë. Në këtë rast, del se numri i atyre që kanë ikur nga Kosova duhet të jetë rreth 274'664. Pra, kjo shifër e shpopullimit të Kosovës ka marrë përmasa alarmante, fshatra të tëra janë braktisur, për çdo ditë dëgjohen fjalë nga rinia se nuk do të rri në këtë vend pa perspektivë. Faktikisht ky është alarm, e nga ana ime apel që të gjithë së bashku ta zgjidhim këtë brengë, më e madhja në vend.

Qytetarët tanë nuk duhet ta humbin shpresën, edhe pse në Kosovë është krijuar një pasiguri kolektive. Në fakt ky është një tregues i qartë që tregon se vendi ynë gjendet në një izolim bashkë me klasën e vet politike, andaj duhet t'i konsolidojmë forcat tona progresive për të dalë nga ky getoizim që dita ditës po e pllakos këtë vend. Kësaj pasigurie kolektive që është krijuar në Kosovë, i ka kontribuar shumë edhe politika e Tiranës e cila nuk ka qenë në mbështetje të politikave zhvillimore të Kosovës.

Për të shpëtuar nga kjo krizë kolektive duhet ta forcojmë arsimin, shkollimin dhe edukimin e brezit të ri. Kosova është e të gjithëve, prandaj t'i tubojmë forcat progresive dhe ta përfaqësojmë Kosovën sa më dinjitetshëm në arenën ndërkombëtare dhe botërore, sepse në disa raste përfaqësimi i dobët i ka sjellë Kosovës pasoja të konsiderueshme.

Nuk e kam kuptuar kurrë dhe vazhdoj të mos e kuptoj se si kaq haptas dhe pa e ndjerë në vete mëkatin politik, që në disa raste nuk është vetëm i tillë, njerëzit e politikës sonë, kur bëhet fjalë për unitet dhe ndërthurjen e mendimit të përbashkët, më lehtë e kanë gjetur të bashkëpunojnë me njerëz të cilët në një kohë jo shumë të largët kanë qenë pjesë e strukturave të masave të dhunshme, e në disa raste edhe të pushtetit të Milloshevigit drejtpërdrejt.

Janë shkruar me miliona shkrime në shtypin tonë në Kosovë se si UÇK-ja ka bërë krime, e shumë pak janë shkruar për strukturat kriminale të shtetit serb, për krimet dhe gjenocidin që e ka bërë shteti serb bashkë me aparatin e vet shtetëror në Kosovë. Vetëm uniteti mund ta mbajë gjallë një popull; vetëm bashkimi shpirtëror mund të arrijë një unitet të përhershëm. Unë besoj dhe jam i bindur se të gjithë patriotët shqiptarë janë gati për t'u shërbyer me besnikëri e për t'i ndihmuar të gjitha strukturat e politikëbërjes për realizimin e detyrës së lavdishme të konsolidimit dhe unitetit zhvillimor të kombit shqiptar.

**(Autori është kryetar i OVL-UÇK-së)**

# Ministri i Mjedisit mbështet katër komuna me projekte në vlerë rreth një milion euro

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 MAJ - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka pritur të martën në takim kryetarët e katër komunave: Prizren, Podujevë, Obiliq dhe Novobërdë, me të cilët ka nënshkruar memorandume të bashkëpunimit për financimin e disa projekteve në fushën e mjedisit. Me rastin e nënshkrimit të këtyre memorandumeve, ministri Matoshi ka ripërsëritur gatishmërinë e tij dhe të ministrisë që ai drejton për përkrahjen e komunave për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Projektet për të cilat u nënshkruan memorandume të bashkëpunimit janë: 1. Ndërtimi i ujësjellësit në




Gjonaj, Prizren, i cili kap vlerën prej 277 mijë eurosh dhe do ta zgjidhë problemin e sigurimit të ujit të pijshëm për banorët e kësaj pjese të Prizrenit; 2. Vazhdimi i projektit të rregullimit të shtratit të lumit Llap, Podujevë, në vlerë prej 150 mijë eurosh; 3. Ndërtimi i kanalizimit Breznicë - Kozaricë, në vlerë totale 100 mijë eurosh për këtë vit dhe, po ashtu, me 100 mijë euro është mbështetur edhe vitin e kaluar; 4. Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimit në fshatin Breznicë - Kozaric - Obiliq, 100 000 euro; 5. Rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjve - Obiliq, 50 000 euro; 6. Pastrimi i lumenjve, përroskave dhe kanaleve, Obiliq, 100 000 euro; 7. Pastrimi i lumenjve në Kufcë, Stanishor, Prekovc dhe llabjan, i cili kap vlerën buxhetore prej 200 mijë eurosh për këtë vit.

Përveç këtyre projekteve, MMPH-ja këtë vit në këto komuna realizon edhe projekte të tjera për të cilat procedurat i zhvillon ministria. "Të gjitha këto projekte janë edhe një hap më shumë për angazhimin tonë të përbashkët për përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe ngritjen e mirëqenies së qytetareve të vendit", ka deklaruar ministri Matoshi. Ai para kryetarëve të këtyre komunave ka shprehur besimin e tij që këto projekte do të realizohen me kohe dhe do të kenë një menaxhim efikas nga komunat përkatëse. Njëkohësisht ministri Matoshi ka kërkuar nga kryetarët një angazhim më të madh për mbrojtjen e mjedisit, mirëmbajtjen e zonave të gjelbra, mbrojtjen e lumenjve nga ndotja dhe, krahas kësaj, t'i vetëdijesojnë qytetarët për mbrojtjen e mjedisit edhe përmes aplikimit të gjobave.

Nga ana tjetër, kryetarët e komunave: Agim Veliu, Mytaher Haskuka, Xhafer Gashi e Svetislav Ivanoviqi falënderuan ministrin Matoshi për përkrahjen e vazhdueshme dhe financimin e këtyre projekteve që, sipas tyre, janë shumë të rëndësishme për mjedisin dhe qytetarët e komunave të tyre.

# Formimi dhe veprimtaria e organizatës patriotike ilegale 'Fronti Nacional Çlirimtar i Kosovës' (FNÇK) 1982 (2)



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Shemsi Veseli thotë se qëllimi i organizatës ishte që të bëhej bashkimi i të gjitha viseve të banuara me shqiptarë dhe të formohej Republika Socialiste e Shqiptarëve në Jugosllavi, kuptohet në kuadër të Federatës Jugosllave. Nuk ishin për një Kosovë etnikisht të pastër, ndërsa pagesa e anëtarësisë në organizatë është bërë sipas parimit të solidaritetit. Ata që kanë qenë të punësuar kanë paguar nga 200 dinarë, ndërsa ata që nuk kanë qenë në marrëdhënie pune kanë paguar nga 100 dinarë. Mjetet e mbledhura kryesisht janë përdorur për blerjen e materialeve të ndryshme ilegale.

Anëtari i katërt i organizatës së FNÇ-së, Esad Brajshori, pranon se në mbledhjen themeluese të organizatës është bërë anëtar i Komitetit dhe ka marrë detyrën e arkëtarit të organizatës, mirëpo refuzon se nga profesori Nezir Myrtaj ka marrë literaturë ilegale. Sa ishte anëtar i organizatës mbante pseudonimin "Lisi". Ndërsa në muajin maj të vitit 1983, në një banesë private, në lagjen Kodra e Diellit në Prishtinë, në radhët e organizatës anëtarëson Ilaz e Afrim Zhitinë, me ç'rast këta para tij japin betimin, ua cakton pseudonimet dhe i bën anëtarë të treshes së tij. Të gjitha këto veprime, me të cilat e ngarkon aktakuza, i ka bërë me vetëdije dhe për asgjë nuk pendohet.

Musli Prebreza, pasi bëhet anëtar i organizatës FNÇ, Eset Bicit dhe Nazmi Prebrezës u flet për qëllimet e organizatës. Në dhjetor të vitit 1983, me iniciativën e Sejdi Veselit për formimin e "komiteteve të vendeve", merr detyrën e delegatit për fshatin Vranidoll.

Para trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë u paraqit edhe Hamdi Rafuna, pasi edhe ky ishte anëtar i organizatës FNÇ. Pasi bëhet anëtar, vepron në "Treshen" e Sejdi Veselit dhe të Sali Sefës, me pseudonimin "Axha". Në dhjetor 1983 merr detyrën e delegatit së bashku me Salih Sefën për formimin e "Komitetit të vendit" në Çeklik dhe Hajvali. Si të gjithë anëtarët e organizatës, ka lexuar literaturë ilegale dhe materiale të ndryshme nga ilegalja.

Nga anëtari i organizatës ilegale, Rrahman Bahtiri, Sabri e Fatmir Sopi mësuan se në Kosovë vepron organizata ilegale me emrin FNÇ. Ata, më vonë, pasi përkrahën programin dhe platformën e saj, u bënë anëtarë.

Me qëllim të ngritjes ideopolitike, udhëheqësia e kësaj organizate i furnizonte me literaturë ilegale dhe me materiale të ndryshme. Me propozimin e Sejdi Veselit, të Rrahman Bahtirit dhe të Musli Prebrezës në fshatin e tyre, në vendin e quajtur "Livadhi i Velisë", gropuan një strehimore me qëllim të strehimit dhe të ruajtjes së materialeve nga organet e sigurimit.

Strehimorja kishte një madhësi solide, 2 metra me 3. Sabriu e Fatmiri, duke bërë përpjekje për masivizimin e FNÇ-së, së bashku me Rrahmanin formuan "Treshen".

Agim Sahiti me Sejdi Veselin njihej që nga viti 1979. Në bisedat që i zhvillonin preokupoheshin kryesisht me pozitën e shqiptarëve nën Jugosllavi dhe me situatën pas ngjarjeve të demonstratave studentore të vitit 1981. Që të dy, nga Nehat Qehaja marrin për lexim revistën "Bashkimi", që ishte organ i "Frontit të Kuq Popullor". Nga Islam Krasniqi është furnizuar me literaturë ilegale. Në një takim Sejdi Veselit i propozon që të ndërmarrin një aksion diversiv kundër autobusit në relacionin Bërnicë e Poshtme - Prishtinë, meqë shumica e udhëtarëve ishin serbë e malazezë. Organizata nuk e miraton këtë kërkesë të tij, por kur të vijë koha do të sendërtohet edhe kjo, në fazën e fundit. Me Sejdi Veselin mbante kontakte të vazhdueshme. Ishte takuar edhe në shtëpinë e tij, e pastaj me të kishin shkuar në shtëpinë e Islam Krasniqit, ku takohen me Rexhep Makollin dhe me Agim Ahmetin.

Tefik Ramadani, nëpërmjet Shemsi Veselit, ishte njohur me Sejdi Veselin. Tefiku ishte defektolog i diplomuar, andaj thotë se ishte krejt e natyrshme që të bisedohej për situatën në Kosovë, sidomos pas demonstratave të vitit 1981.

Gjatë vitit 1982, në kontaktet me Sejdi Veselin dhe me Agim Sahitin, bisedonin edhe për ngritjen ideopolitike. Para trupit gjykues Tefik Ramadani shumë të dhëna nuk i pranon, por shpalljen e Kosovës republikë e sheh si zgjidhje të vetme dhe të drejtë.

Muhamet Kryeziu nuk e pranon aktakuzën dhe pohon se të gjitha këto që i ngarkohen janë montime. Çdo gjë që ka pranuar në hetuesi e ka bërë për shkak të dhunës nga punëtorët e hetuesisë. Kryeshefi i Entit Krahinor për Mbrojtjen Shëndetësore në Institutin Epidemiologjik të Prishtinës, dr. Skender Boshnjaku, para trupit gjykues, pjesërisht pranoi aktakuzën, mirëpo për atë që pranoi se e kishte lexuar librin e Enver Hoxhës, nuk mendon se ka bërë ndonjë faj. Libri lexohet edhe nga kureshtja. Me Sejdiun (Veselin) thotë se gjatë tërë kohës kam pasur raporte të mira dhe se atë e kam çmuar shumë, ngaqë ka qenë aktivist i dalluar dhe se ka qenë sekretar i OTH të LK-së, komandant i AFP-së "Ibër - Lepenci", andaj edhe nuk kam dyshuar në veprimtarinë e tij.

Sipas Aktakuzës PP. nr. 60/84, lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, mund të konkludohet se Iliaz Zhitia gjatë vitit 1981 në Prishtinë është bërë anëtar i organizatës ilegale Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi (PKMLShJ). Gjatë tërë kohës sa zgjasin demonstratat studentore ai merr pjesë aktive në to, duke brohoritur parulla të ndryshme për statusin e Kosovës Republikë. Pasi më 1983 nga shërbimi ushtarak kthehet në Prishtinë, bie në kontakt me Esad Brajshorin dhe fillon përsëri me aktivitet ilegal. Nga Esadi furnizohet me literaturë dhe me materiale të ndryshme ilegale. Më vonë, po në këtë vit, me propozimin dhe sipas tekstit që e kishte përpiluar Esad Brajshori, me makinë shtypi shumëzoi 53 ekzemplarë të afishes së quajtur "Trakt", të cilat më 4 prill u shpërndanë në lagjen Kodra e Diellit, ndërsa një numër të caktuar ia jep Afrim Zhitisë, që i shpërndan në fshatin Llugë. Gjatë muajit maj 1983 bëhet anëtar i organizatës FNÇ, së bashku me Afrim Zhitinë. Pranimin e tyre e bën Esad Brajshori. Ai jep betimin në mënyrë solemne, duke vepruar nën pseudonimin "Albi", paguan anëtarësinë dhe formon grupin e "Treshes".

Esad Brajshori Afrim Zhitinë e njofton në hollësi për veprimtarinë e organizatës FNÇ. Nga ai merr për ta lexuar "Programin" dhe "Statutin" e saj. Pastaj disa trakte i shpërndan në Prishtinë dhe në fshatin Llugë. Në një shtëpi private në lagjen Kodra e Diellit, para Esad Brajshorit jep betimin solemn dhe i caktohet emri konspirativ "Besimi". Sipas obligimeve që marrin nga organizata, ai angazhohet në anëtarësimin sa më të madh të anëtarëve të rinj për t'i formuar "treshet", lexonte dhe këmbente literaturë ilegale.

Edhe Ramadan Avdiu ishte anëtar i organizatës ilegale FNÇ. Në tetor 1982 para Shemsi Veselit jep betimin solemn dhe merr emrin konspirativ "Minori". Me veprimtari ilegale ka filluar të merret në moshë shumë të re që nga viti 1982. Po në tetor të vitit 1982 në takimet që ka pasur me disa persona, ai formon dy grupe ilegale në formë të "Treshes". Më vonë para tij e japin betimin solemn, marrin emrat konspirativë, paguajnë anëtarësinë dhe vazhdojnë të këmbejnë e të lexojnë materiale me përmbajtje kundër shtetit, siç ishin: "Udhëzimet e FNË"-së, "Armiku na ka në dorë aq sa lejojmë vetë".

Gjatë muajit mars 1983 nga Shemsi Veseli merr edhe 60 copë afishe lidhur me përvjetorin e dytë të demonstratave, të cilat së bashku me dy anëtarë të "Treshes" i shpërndajnë në lagjen "Dragodani" Salih Sefa është një ndër themeluesit e organizatës ilegale të FËK-ut qysh nga viti 1981 dhe ka punuar në grupin e "Treshes", ku ka qenë i angazhuar edhe Hamdi Rafuna. Aktivitet të dendur ka treguar në angazhimin e anëtarëve të rinj në radhët e organizatës. Rreth vetes kishte mbi 70 persona të gatshëm të vepronin ilegalisht për të mirën e popullit shqiptar. Sali Sefa emrin për veprimtari ilegale e kishte "Cërci". Pas mbledhjes së 17 shkurtit 1982, që u mbajt në Shkollën Fillore "Zenel Hajdini" në Prishtinë, organizata bëri disa ndryshime në emërtim dhe njëherësh miratoi "Programin" dhe "Statutin" e saj. Udhëheqësi i organizatës, Sejdi Veseli, u takua me Salih Sefën dhe e njoftoi për të gjitha që kishin ndodhur brenda organizatës. Në atë takim Salih Sefa i jep Sejdiut traktin që e kishte përpiluar vetë me emrin "Lexoje, shpërndaje, armikut mos ia dorëzo", të cilin më vonë Shemsi Veseli e shumëzon dhe e shpërndan në Bashkësinë XII Lokale Prishtinë. Gjatë muajit mars Salihu përsëri takohet me Sejdiun dhe bisedojnë për organizimin e demonstratave në dyvjetorin e tyre. Salihu këtë propozim e refuzon duke theksuar se nuk ishte i autorizuar që të ndërmerrte ndonjë aksion pa direktivën e shokëve nga organizata PKMLShJ, të cilët ndodheshin në Turqi.

Në takimet e shpeshta që ka pasur me Hamdi Rafunën, Musli Prebrezën dhe Sejdi Veselin, kanë lexuar dhe kanë këmbyer mendime rreth veprave të lexuara. Në muajin dhjetor, me iniciativën e Sejdi Veselit, Salih Sefa, së bashku me Hamdi Rafunën, kanë marrë materialin dhe udhëzimet për formimin e "Komitetit të Vendit" në Çeklik e Hajvali.

Në aktakuzën e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, për Xhemajl Rexhepin nuk thuhet se ishte anëtar i ndonjë organizate ilegale, por nga Sejdi Veseli në muajin maj 1983, derisa ishte në fshatin Stallovë, në kuadër të aksionit të vëzhguesve "Maji i kuq" (ai ishte kryeshef i aradhes së vëzhguesve), pasi që ka vërejtur në tendën e tij (të S. V.), revistën "Zëri i Kosovës", nr. 1 e 2, ato i ka shfletuar dhe ia ka bërë me dije se e di që ai merret me veprimtari ilegale. Kontaktet e tij me Sejdiun vazhdojnë edhe pasi kthehen në Prishtinë. Edhe më tej fillon të lexojë literaturë ilegale që e siguronte nga Sejdi Veseli. Pasi që Xhemajl Rexhepi ishte punëtor në Qendrën Elektroteknike të SKPB-së, e njoftonte për hollësitë e detyrave që i kishte kryer në Qendër dhe, njëherësh, i tregon se cilët persona janë të përshtatshëm për veprimtari ilegale.

Kadri Haziri, i cili ishte punëtor i Fabrikës së Tjegullave në Podujevë, për disa probleme të organizatës së tij e njoftonte Ilaz Zhitinë. Së bashku me të përpiloi afishe të cilat i vulosnin me vulën e organizatës dhe i shpërndau në OPB "8 Nëntori" të Komunës së Podujevës dhe aksionin e kishte kryer me sukses.

Në këtë proces gjyqësor i fundit i cili merret në pyetje është Rexhep Makolli. Ai e pranon se ka marrë pjesë në takimin e mbajtur në shtëpinë e Islam Krasniqit, ku është biseduar për situatën e rëndë që e ka kapluar Kosovën, se si Serbia po e shfrytëzon atë dhe populli shqiptar po vuan nën robëri. Me të gjitha këto qëndrime Rexhep Makolli është pajtuar, bile edhe është interesuar tek Agim Ahmeti, se cila ishte mundësia e inkuadrimit në organizatën ilegale PKMLKShJ.

(**Fund.** Fusnotat i ka hequr redaksia)



Afrim Zhitia



Esat Brajshori



Ramadan Avdiu



Tefik Ramadani



Rrahman Bahtiri




# Sport




# Kastrioti synon t'i japë fund dominimit të Besës edhe në kampionat

Në konkurrencën e meshkujve finalen e parë e zhvillojnë Kastrioti dhe Besa Famgas. Skuadra nga Ferizaj po synon që t'i japë fund dominimit disavjeçar të skuadrës nga Peja në hendbollin e Kosovës. Ndërsa në konkurrencën e femrave trofeun e kërkojnë Istogu dhe Vushtrria. Skuadra nga Rrafshi i Dukagjinit po synon të hyjë në histori duke e fituar titullin, kurse Vushtrria beson se do ta rikthejë trofeun e më të mirit



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 21 maj - KH Kastrioti nga Ferizaj, pas i dha fund dominimit të Besa Famgas në garën e Kupës, të njëjtën po synon të bëjë edhe në kampionat. Finalja e parë në mes të këtyre dy skuadrave zhvillohet sonte (e mërkurë) në Palestrën "Karagaçi" në Pejë nga ora 20:30. Hendbollisti Arben Dugolli e vlerëson maksimalisht kundërshtarin pejan, por është shumë optimist se skuadra nga Ferizaj do ta fitojë titullin e kampiones. "Na presin ndeshje shumë të forta, pasi të dy skuadrat kanë lojtarë cilësorë. Jemi më të mirë se kundërshtari dhe jemi të motivuar nga triumfi në Kupë, prandaj do të triumfojmë edhe për titull", ka thënë Dugolli.

Për ndeshjen e parë finale foli edhe hendbollisti i Besës, Ante Kukrika. Ky i fundit ka thënë se skuadra nga Peja duhet të shfrytëzojë në maksimum epërsinë e terrenit vendës dhe ta fitojë titullin. "Sigurisht se do të jetë vështirë, pasi Kastrioti është ekip i mirë. Është me shumë rëndësi që kemi siguruar vendin e parë në stinorin e rregullt, që kemi përparësinë e terrenit vendës. Të gatshëm e presim finalen", ka thënë Kukrika.

Ashtu sikurse në konkurrencën e meshkujve, edhe në atë të femrave gara për titull është mjaft e fortë. Dy skuadrat finaliste, Istogu dhe Vushtrria, po synojnë të dalin triumfuese. Sipas trajnerit të Istogut, Frauk Shala, është koha që skuadra e tij ta bëjë hapin e radhës duke e fituar për herë të parë titullin e kampionit në Superligë. Shala ka thënë se përkrahja për vashat që ai i drejton nuk po mungon dhe se do të jetë e madhe edhe të mërkurën në Palestrën "Karagaçi". "Tani është koha për hapin e radhës. Qyteti i Istogut meriton të ketë skuadër kampione dhe ne do të japim çdo gjë që të arrijmë këtë objektiv. Jemi të vetëdijshëm se do ta kemi vështirë, përpara kemi një skuadër me traditë dhe përvojë, por kam besim në kualitetin e skuadrës sonë. Mendoj se skuadra e Istogut është më cilësore dhe ka synim vetëm fitoren. Vushtrria është e motivuar, por të motivuar jemi edhe ne. Asnjëherë nuk kemi qenë më afër titullit. E kemi edhe përkrahjen e publikut në Pejë. I gjithë qyteti i Istogut është pranë nesh. Këto vajza nuk i kanë zhgënjyer qytetarët asnjëherë dhe kështu do të jetë edhe në finale", ka deklaruar Shala.

Pavarësisht se Vushtrria ka pësuar humbje në finale të Kupës nga Istogu, trajneri i kësaj skuadre, Arben Parduzi, vazhdon të jetë optimist për finalet e titullit. Trajneri Parduzi beson se Vushtrria do të festojë. "E dimë që Istogu ka skuadër cilësore, por ne si klub i kemi synimet tona për titull të kampionit. Vashat janë shumë të motivuara dhe shpresojmë në paraqitje të mirë qysh në ndeshjen e parë në Pejë. Kështu do ta presim ndeshjen e dytë në Vushtrri, në një atmosferë të zjarrtë dhe ta festojmë titullin e kampionit", ka thënë Parduzi.

Ndeshja e parë në mes këtyre dy skuadrave zhvillohet sot (e mërkurë) në Pejë nga ora 18:00.

# Kosova mëson kundërshtarët e Botërorit

Prishtinë, 21 maj - Përfaqësuesja U21 e Kosovës në hendboll do të luajë në Grupin C në Kampionatin Botëror të Juniorëve, i cili mbahet në muajin korrik në Spanjë. Në shortin e hedhur të martën, Kosova ka rënë në një grup me Portugalinë, Kroacinë, Hungarinë, Brazilin e Bahrejnin. Bëhet fjalë për një grup të fortë me kombëtare cilësore, por djelmoshat e Kosovës do ta japin maksimumin për paraqitje të denjë dhe për të shënuar fitore. Është hera e parë që një përfaqësuese e Kosovës do ta paraqitet në botëror. Pra, është një sukses tjetër historik i hendbollit. Kosova në short ishte në vazon e fundit. Shorti u hodh në Pontevedra të Spanjës. Në grupin A janë Sllovenia, Spanja, Serbia, Tunizia, Japonia e ShBA-ja. Në grupin B garojnë Franca, Egjipti, Suedia, Nigeria, Korea e Australia. Në grupin D garojnë Gjermania, Islanda, Norvegjia, Argjentina, Danimarka e Kili.



# Prishtina: Kokën lart djema, vazhdojmë përpara



Prishtinë, 21 maj - Skuadra e Prishtinës e ka përfunduar kampionatin 2018/2019 në vendin e dytë, pasi në ndeshjen e fundit vendimtare për titull pësoi humbje nga Feronikeli (1-0). Klubi kryeqytetas nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka vlerësuar se ky grup i lojtarëve do të mbahet në mend për çiltërsinë dhe karakterin e lartë. "Të gjithë ata që ju njohin e dinë sa keni sakrifikuar për një vit në gara. Krejt çfarë keni arritur e keni arritur vetëm me mundin tuaj. Humbja e titullit dhemb shumë, por mundin në 32 ndeshjet e tjera askush s'mund t'jua humbë. Gjenerata juaj do të mbahet në mend për çiltërsinë dhe karakterin e lartë që keni treguar. FC Prishtina ka vite që nuk ka pasur ekip më të bashkuar, të drejtë moralisht e sportistë të vërtetë. Kokën lart djema, vazhdojmë përpara!", thuhet në postimin e FC Prishtina.

## Batatina me akuza të reja për FFK-në

Prishtinë, 21 maj - Trajneri i Llapit, Tahir Batatina assesi nuk po gjënë paqe me drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK). Batatina nëpërmjet një postimi në "Facebook" e ka kritikuar Federatën e Futbollit me organizimin e ceremonisë se ndarjes së titullit të kampionit në Drenas. Batatina këtë postim e ka përcjell me një video nga ceremonia e Federatës së Italisë. "Kështu bëhet organizimi i titullit FFK... Nëse nuk dini, mund të pyesni. Mjete keni deklaruar në Kuvendin e Punës 'pesë milionë euro', ndërsa titulli jepet sikurse në kohën e okupimit sa ishte futbolli i Kosovës. A jeni duke e ditur se ne jemi pjesë e futbollit evropian?! Mos i humbni investitorët, mos i zhgënjeni adhuruesit e futbollit dhe mos i fyeni futbollistët që derdhën djersën për 12 muaj rresht deri te suksesi", ka shkruar Batatina në "Facebook".



## Kukësi rikthen interesimin për Thaqin

Kukës, 21 maj - Drejtuesit e skuadrës së Kukësit po kërkojnë të afrojnë 3-4 lojtarë që ta bëjnë diferencën, duke filluar nga Kupat e Evropës. Gazeta "Panorama Sport" mëson ekskluzivisht se verilindorët i janë rikthyer sërish pistës së Armend Thaqit. Ai ka qenë në fokusin e verilindorëve edhe një vit më parë kur ekipi drejtohej nga Peter Pakult, por zgjodhi që të transferohej nga Gjilani te Prishtina. Në atë kohë marrëveshja nuk u konkretizua edhe për shkak të pretendimeve të larta ekonomike të ish-mbrojtësit të Përfaqësueses së Kosovës. Drejtori sportiv e ka takuar sërish 26-vjeçarin. Duke parë që përfundimi i sezonit është në prag dhe kupat e Evropës nisin vetëm një muaj më pas, nuk ka shumë kohë për t'u menduar.



# FHK-ja reagon në IHF për trajtimin diskriminues në Spanjë




Prishtinë, 21 maj - Federata e Hendbollit e Kosovës ka reaguar menjëherë të martën te drejtuesit e Federatës Ndërkombëtare të Hendbollit (IHF) për trajtimin diskriminues dhe jo të barabartë të saj në ceremoninë e shortit për Kampionatin Botëror në Hendboll që u mbajt në Pontevedra në Spanjë. Në shortin për Botërorin e Juniorëve që mbahet në korrik në Spanjë, Kosova është prezantuar me logon e FHK-së dhe jo me flamurin shtetëror të Kosovës, siç janë prezantuar vendet e tjera. "Jemi të indinjuar dhe të befasuar nga ky akt i mosrespektit dhe trajtimit jo të barabartë të Kosovës si shtet dhe, po ashtu, të FHK-së. Jemi të befasuar nga trajtimi i tillë i Kosovës nga ana e Federatës Spanjolle të Hendbollit dhe të përfaqësuesit të IHF-së, Per Bertelsen, i cili e udhëhoqi shortin", thuhet në letrën që presidenti i FHK-së, Eugen Saraçini, ia ka dërguar presidentit të IHF-së, Hassan Moustafa dhe anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të IHF-së.

FHK-ja urgjentisht ka kërkuar sqarim nga IHF-ja për këtë çështje si dhe ka kërkuar që FHK-ja dhe Kosova të respektohen si të gjitha vendet e tjera pjesëmarrëse në Kampionatin Botëror U21 që do të mbahet në muajin korrik në Spanjë. "FHK-ja lidhur me këtë akt ka informuar edhe Komitetin Olimpik të Kosovës, nga i cili ka kërkuar të reagojë te Komiteti Olimpik Ndërkombëtar", thuhet në reagimin e nënshkruar nga presidenti Saraçini.

# Golden State shkruan historinë me finalen e pestë radhazi

Oakland, 21 maj - Golden State plotëson pritshmëritë dhe kualifikohet për në finalen e madhe të kampionatit amerikan të basketbollit, NBA, për të pestin vit radhazi, diçka që nuk ndodhte prej 50 vjetësh. Skuadra kampione në fuqi fitoi edhe ndeshjen e katërt ndaj Portland Blazersit me rezultatin 119-117, por këtë radhë e pati shumë më të vështirë sesa herët e tjera, pasi u desh ta zgjidhte sfidën vetëm pas kohës shtesë. Në sfidën e zhvilluar në "Moda Center", Warriorsi ishte sërish pa Kevin Durantin e dëmtuar, por mungesa e tij nuk u ndje edhe këtë radhë, kjo për meritë të të zakonshmit Stephen Curry, i cili zhvilloi sërish një ndeshje fantastike kundrejt Trailblazers, të cilën e mbylli me 37 pikë, 13 topa në tabelë e 11 asistime.



Por, Curry nuk ishte i vetëm në këtë fitore të skuadrës kaliforniane. Ai pati edhe ndihmën e Draymond Green, i cili regjistroi një bilanc me 18 pikë, 14 topa në tabelë dhe 11 asiste, ndërkohë që nuk duhet harruar as kontributi i Klay Thompsonit, edhe pse u duk si më në hije sesa shokët e tij të skuadrës, me 17 pikë, 6 topa në tabelë e 2 asistime. Thompsoni ka meritën që shënoi pikët që vulosën fitoren e skuadrës së Golden State në sekondat e fundit të takimit. Ndërsa te Portlandi nuk mjaftuan 84 pikët e shënuar në total nga treshja Lillard, McCollum dhe Leonard, për ta shtyrë festën e Golden States. Kjo e fundit pret e qetë përfundimin e duelit mes Milwaukeet dhe Torontos, me fituesin e të cilit do ta diskutojë çështjen e titullit kampion të NBA-së.

## SHKURT

### Formula 1 në zi, shuhet legjenda Niki Lauda

Tri herë kampioni i Formulës 1, Niki Lauda, ka vdekur në moshën 70-vjeçare. Legjenda austriake kishte fituar titujt për Ferrarin më 1975 dhe 1977 dhe McLarenin më 1984. Ai do të mbahet mend për shumë admirues të garave motorike për rikuperimin e shpejtë dhe kthimin në gara pasi vetura e tij u dogj në garën e vitit 1976 në Gjermani. Ai kishte pësuar djegie të shkallës së tretë në kokë dhe fytyrë pas një aksidenti në Nurburgring. Pas karrierës si garues, Lauda shërbeu si shef joekzekutiv i ekipit të Mercedesit në Formula 1. Familja e tij ka njoftuar se Lauda vdiq të hënën.

### Schulzi transferohet nga Dortmundi

Pasi dështoi në kampionat, duke mos fituar titullin kampion, Borussia Dortmundi ka filluar të mendojë menjëherë për sezonin e ardhshëm. Nënkampionët e Gjermanisë kanë zyrtarizuar një blerje të bujshme. Bëhet fjalë për futbollistin e kombëtares gjermane, Nico Schulz. Mbrojtësi 26-vjeçari, që u transferua nga radhët e Hoffenheimit, i kushtoi plot 27 milionë euro klubit verdhezi. Ai zhvilloi një sezon të shkëlqyer teksa spikati edhe me paraqitjet fantastike me ekipin kombëtar.

### Kroosi mirëpret Pogban në Real

Mesfushori gjerman i Real Madridit, Toni Kroos, këmbëngul se nuk do të heqë dorë nga vendi startues në formacionin e Realit edhe nëse ylli i Manchester Unitedit, Paul Pogba, i bashkohet "Los Blancos" gjatë verës. "Mund të flasim për shumë emra. Më pëlqen ky lojtar, por asgjë nuk ndryshon për mua. Unë do të vazhdoj të bëj atë që kam bërë gjatë gjithë këtyre viteve, duke luftuar për vendin tim, duke luajtur mirë dhe kur jam në një nivel të mirë unë mendoj se nuk kam probleme", ka deklaruar Kroosi.

### Mkhitaryani nuk luan në finale të Ligës së Evropës

Henrikh Mkhitaryan nuk do të udhëtojë me Arsenalin për në Azerbajxhan për të luajtur në finalen e Ligës së Evropës. Vendimi është marrë nga klubi londinez, pas konsultimit me lojtarin dhe familjen e tij. Futbollisti armen ka kohë që përflitet se nuk do të shkonte në Baku për shkak të situatës politike në mes të Azerbajxhanit dhe Armenisë. Zyrtarë azerë ditët e fundit kanë garantuar për sigurinë e tij, por Arsenali ka vendosur të mos rrezikojë, edhe pse bëhet fjalë për një lojtar të rëndësishëm. Një skandal i madh, që ka për autor UEFA-n, sepse zgjedhja e Bakut si vend për finalen dihej që në fillim që ishte e dyshimtë dhe plot probleme.

### Xavi: Messi luan edhe katër vjet në nivelin më të lartë

Ish-mesfushori legjendar i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka thënë se Lionel Messi do të vazhdojë të luajë edhe për tri apo katër vjet të tjera. Kur u pyet nga "Sport" nëse Barcelona duhej të kishte arritur të më shumë suksese gjatë kohës sa Messi ka qenë në skuadër, Xavi ia kujtoi gazetarit se para argjentinasit, Barcelona e kishte vetëm një titull të Ligës së Kampionëve. "Kemi më shumë sesa mjaftueshëm, e kishim vetëm një më parë. Ne kishim mundësi të fitonim edhe më shumë, por është e vështirë të arrish të triumfosh në Ligën e Kampionëve. Barcelona e Pep Guardiolës ishte më e mirë sesa cilado skuadër tjetër dhe ne i fituam vetëm dy nga katër trofetë e Ligës së Kampionëve gjatë asaj kohe. Chelsea dhe Interi na eliminuan", ka thënë Xavi. "Por, qetësohuni, Messi nuk ka përfunduar ende. Ne gjithmonë flasim për epokën pas Messit, por Leo i ka edhe tri apo katër vjet të mira për të luajtur. E kam fjalën për të luajtur në nivelin më të lartë, si tani, sepse ai kujdeset për veten, ai është fizikisht i fuqishëm dhe ka mendësinë e një përbindëshi. Ai është numri një në gjithçka", ka shtuar Xavi.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*
*Centralna Izborna Komisija*
*Central Election Commission*

Në bazë të bazë të nenit 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L- 149, për Shërbimin Civil të Republikes së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.04/L-077, për Marëdhënjet e Detyrimeve, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bënë:

**Rishpallje të konkursit publik**
**Për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

| | |
|---|---|
| 1. Emri i Institucionit: | **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** |
| 2. Titulli i Vendit të Punës: | **Asistent Ekzekutiv i Kryetarit të KQZ-së** |
| 3. Numri i referencës: | **KQZ-11/2019** |
| 5. Grada e Vendit të Punës: | **NA – G8 / K – 12** |
| 6. Lloji i kontratës : | **Me kohë të caktuar** |
| 9. Raporton tek: | **Kryetari i KQZ-së** |
| 10.Vendndodhja: | **Prishtinë** |

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
1. Aranzhon takimet e Kryetarit-ës të KQZ-së;
2. Procedon çështjet administrative lidhur me funksionimin efikas të Zyrës së Kryetarit te KQZ-së.
3. Në emër të kryetarit-ës së KQZ-së, pranon, rishikon dhe sistemon materialet që arrijnë në adresë të KQZ-së, dhe sipas nevojës i dërgon në adresa të caktuara;
4. Mirëmban dhe azhurnon raportet, korrespondencën dhe materialet e tjera relevante;
5. Bën përgatitjen teknike të mbledhjeve të KQZ-së;
6. Detyra dhe përgjegjësi të tjera që i caktohen nga mbikëqyrësi;

**Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:**
1. Diplomë Universitare;
2. Dy (2) vite përvojë pune;
3. Integritet të lartë personal dhe profesional;
4. Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
5. Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
6. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare e dëshirueshme;
7. Njohje e gjuhës angleze me gojë dhe me shkrim e dëshirueshme;
8. Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access).

**Procedura e konkurimit**
Formularet për punësim mundë të merren në zyren e personelit apo në webfaqen e KQZ-së, në linkun www.kqz-ks.org. *Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me konkurs, në zyrën e personelit në SKQZ, Rruga "Migjeni, nr. 21. 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës me anë të shërbimit postar.*
*Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura dhe , Certifikatë (dëshminë) që s'është nën hetime.*
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuar.*
*Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.*
*Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listë të ngushtë do të kontaktohen.*
***Afati i aplikimit është i hapur tetë (8) ditë nga dita e publikimit, nga data 22.05.2019 deri me 29.05.2019.***

*Për informata shtese ju lutem kontaktoni në numrin e telefonit* ***038-200-23-557.***

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*
*Centralna Izborna Komisija*
*Central Election Commission*

Na osnovu člana 12, stav 4 Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, na osnovu Zakona br. 04 / L-077 o obaveznim odnosima, Sekretarijat Centralne izborne komisije objavljuje:

**Ponovno objavljivanje javnog konkursa**
**o Sporazumu za posebne usluge**

| | |
|---|---|
| 1. Naziv institucije: | **Centralna izborna komisija** |
| 2. Naziv radnog mesta: | **Izvršni asistent Predsednika CIK-a** |
| 3. Referentni broj: | **KQZ-11/2019** |
| 5. Stepen radnog mesta: | **NA – G8 / K – 12** |
| 6. Vrsta ugovora : | **Na određeno** |
| 9. Izveštava kod: | **Predsednik CIK-a** |
| 10. Lokacija: | **Priština** |

**Zadatci i odgovornosti:**
1. Organizuje sastanke Predsednika/ce CIK-a;
2. Prosleđuje administrativna pitanja koja se odnose na efikasno funkcionisanje kancelarije Predsednika CIK-a.
3. U ime predsednika/ce CIK-a, prihvata, razmatra i sistematizuje materijal koji stiže na adresu CIK-a, a ako je potrebno šalje ga na određenu adresu;
4. Održava i ažurira izveštaje, prepisku i druge relevantne materijale;
5. Vrši tehničku pripremu sastanaka CIK-a;
6. Obavlja ostale dužnosti i odgovornosti koje su mu dodeljene od strane nadzornika;

**Kvalifikacije, veštine i radno iskustvo:**
1. Univerzitetska diploma;
2. Dve (2) godine radnog iskustva;
3. Visok lični i profesionalni integritet;
4. Odlične veštine usmene i pismene komunikacije na službenim jezicima;
5. Sposobnost i spremnost da radi nepristrasno i sa ljudima različitog etničkog porekla;
6. Poznavanje drugog službenog jezika je poželjno;
7. Usmeno i pismeno poznavanje engleskog jezika je poželjno;
8. Poznavanje informativne tehnologije (MS Word, MS Excel i MS Access).

**Postupak nadmetanja**

Obrasci za zapošljavanje mogu se preuzeti u kadrovskoj kancelariji ili na veb stranici CIK-a na linku www.kqz-ks.org. *Obrazci za zapošljavanje podnose se unutar roka odredenog konkursom, u Kadrovskoj kancelariji u SCIK-u, ulica "Migjeni" br. 21. 10000 Priština, svakog radnog dana od 08:00 - 16:00, putem pošte koristeći poštanske usluga.*
*Obrascu za zapošljavanje prilažu se i kopije neophodnih ličnih dokumenata i dokazi o kvalifikaciji, radnom iskustvu, pohađanju obuka i Potvrda (dokaz) da nije pod istragom.*
*. Centralna izborna komisija pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i podstiče prijave svih osoba muškog i ženskog pola, kao i članova svih zajednica na Kosovu, uključujući i osobe sa ograničenim sposobnostima.*
*Prijave dostavljene nakon predviđenog roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.*
*Samo kandidati izabrani u uži krug će biti kontaktirani.*
***Rok za prijavu je otvoren osam (8) dana od dana objavljivanja, od 22.05.2019. do 29.05.2019.***

*Za dodatne informacije kontaktirajte broj telefona* ***038-200-23-557.***

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
**K.R.M. "ÇABRATI"**
*Tel.+381(0)390/321 588*
*+381(0)390/324 034*
*www.cabrati.com*
*e-mail. info@cabrati.com*
*Gjakovë - Gjakova*

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212) dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 15.05.2019 vendosi që me datë 22.05.2019 të shpallë :

**Konkurs publik**

**Për këto pozita si vijon:**

**I .** 1 /një/ <u>**KOORDINATOR PËR DEPO**</u> kohë të caktuar **( me kohëzgjatje 1 /një/ vjeçare),** me mundësi vazhdimi.

**Kushtet:**
Të posedojnë fakultetin Ekonomik apo Juridik, të ketë më së paku 6 (gjashtë) muaj përvojë të punës relevante, të ketë aftësi të mira fizike për punë me ngarkesa dhe përballje me kushtet në terren që kërkon vendi i punës, preferohet posedimi i patentë shoferit me "B" kategori më së paku, të mos jetë i dënuar apo nën hetime .
**Kushtet e veçanta**:
Të ketë aftësi të mira psikofizike të punës, puna kryhet me ngarkesa shtesë të detyrave të punës dhe në vende të ndryshme varësisht nga nevoja e punëdhënësit dhe mundësi të ndërrimit të vendit të punës për pozitë ekuivalente. Punëtori 6 /gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do t'i vazhdohet apo do t'i ndërpritet kontrata e punës.

**Dokumentet e kërkuara**:
Kërkesa, CV-ja, Diploma , Referenca e përvojës 6 (gjashtë) muaj në punët relevante, të posedoj patentë shoferin me "B" kategori së paku, Raport mjekësor se posedon aftësi të mira shëndetësore për pozitën që konkurron , Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i dënuar ( më e re se gjatë muaj) dhe Letër Njoftimi.

**II. 1.** /një/ **ZYRTARE ADMINISTRATIVE NË ARKIV** kohë të caktuar **( me kohëzgjatje 1 /një/ vjeçare),** me mundësi vazhdimi.
**Kushtet:**
Të posedojnë shkollim të mesëm, të ketë më së paku 1 (një) vit përvojë të punës për pozitë relevante, të ketë aftësi të mira fizike për punë me ngarkesa, të ketë njohur të punës me Kompjuter, të mos jetë i dënuar apo nën hetime.

**Kushtet e veçanta**:
Të ketë aftësi të mira psikofizike të punës, puna kryhet me ngarkesa shtesë të detyrave të punës dhe në vende të ndryshme varësisht nga nevoja e punëdhënësit dhe mundësi të ndërrimit të vendit të punës për pozitë ekuivalente. Punëtori 6 /gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij/saj do t'i vazhdohet apo do t'i ndërpritet kontrata e punës.
**Dokumentet e kërkuara**:
